



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 121

Tiranë – E mërkurë, 9 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 39/2025, datë 26.6.2025	Për kontrollin e kufirit shtetëror..... 18463
Dekret i Presidentit nr. 217, datë 7.7.2025	Për shpallje ligji..... 18477
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 374, datë 2.7.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2025”..... 18477
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 2, datë 26.6.2025	Për metodologjinë e mbledhjes së të dhënave statistikore kombëtare të sistemit të drejtësisë..... 18478



LIGJ
Nr. 39/2025

PËR KONTROLLIN E KUFIRIT
SHTETËROR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe bashkëveprimin ndërmjet autoriteteve kombëtare përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Kontroll kufitar” është veprimtaria që kryhet në përputhje dhe për qëllim të këtij ligji në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar ose aktit të

kalimit të kufirit, pavarësisht rrethanave dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar dhe mbikëqyrja kufitare.

2. “Mbikëqyrja e kufirit” është tërësia e masave që zbaton Policia Kufitare dhe e Migracionit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në segmentet e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe në pikën e kalimit kufitar, përfshirë ujërat e brendshme dhe ujërat territoriale, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, kalimit të paligjshëm të kufirit dhe migracionit të parregullt.

3. “Menaxhimi i integruar i kufirit” është koordinimi dhe bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar nga autoritetet dhe agjencitë përkatëse të përfshira në menaxhimin e kufirit në përputhje me kuadrin ligjor, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, si dhe traktatet, dypalëshe ose shumëpalëshe, të lidhura me vendet e tjera.

4. “Pikë e kalimit kufitar” është çdo vend kalimi, i autorizuar nga autoritetet kompetente për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

5. “Pikë e përbashkët e kalimit kufitar” është çdo pikë e kalimit kufitar, e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e një shteti fqinj, në të cilën rojat kufitare shqiptare dhe rojat kufitare të shtetit fqinj kryejnë verifikime kufitare në hyrje dhe në dalje, njëri pas tjetrit, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar dhe sipas marrëveshjes përkatëse dypalëshe.

6. “Roje kufitare” është çdo punonjës i Policisë Kufitare dhe Migracionit, i caktuar në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror për të kryer detyra të kontrollit kufitar në përputhje me këtë ligj.

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- rregulloren e (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (kodi i kufijve Schengen)”, e ndryshuar. Nr. CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 77, datë 23.3.2016, faqe 1–52;

- rregulloren (BE) 2019/1896 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2019, “Për rojat kufitare dhe bregdetare evropiane”, që shfuqizon rregulloret (BE) nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624”. Nr. CELEX 32019R1896, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 295, datë 14.11.2019, faqe 1–131;

- rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2021/581, datë 9 prill 2021, “Mbi pasqyrimin e informacionit të Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes Kufitare (EUROSUR)”. Nr. CELEX 32021R0581, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 124, datë 12.4.2021, faqe 3–39;

- rregulloren (KE) nr. 1931/2006, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 dhjetor 2006, “Vendosja e rregullave për trafikun kufitar lokal në kufijtë tokësorë të jashtëm të shteteve anëtare dhe që ndryshon dispozitat e Konventës *Schengen*”. Nr. CELEX 32006R1931, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 405, datë 30.12.2006, faqe 1–22.



7. “Verifikim kufitar” është veprimtaria që kryhet në pikën e kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për të dalë prej tij.

8. “Verifikimi vijës së dytë” është një verifikim i mëtejshëm, i cili mund të kryhet në një vend të posaçëm, tej vendndodhjes së vijës së parë, në të cilën kryhen verifikime minimale ose tërësore për të gjithë personat.

9. “Zonë e verifikimit kufitar” është një zonë e përcaktuar dhe e shënuar në të cilën mund të kryhen verifikime sipas dispozitave të këtij ligji.

10. “Qarkullim lokal kufitar” është kalimi i rregullt i një kufiri shtetëror tokësor nga banorët kufitarë, me qëllim që të qëndrojnë në një zonë kufitare për arsye sociale, kulturore ose ekonomike, të bazuara ose për arsye familjare, për një periudhë që nuk e kalon kufirin kohor të përcaktuar në këtë ligj.

11. “Vendkalime të veçanta kufitare” janë vendkalime të miratuara në marrëveshje vetëm për qarkullimin lokal ndërkufitar.

12. “Verifikim kufitar i automatizuar” është përdorimi i pajisjeve elektronike, ku mbledhen të dhëna për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar.

13. “Pasagjer” është çdo person, përfshirë edhe personat që udhëtojnë transit në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të anëtarëve të ekuipazhit dhe që rezultojnë në listën e pasagjerëve.

14. “Informacioni paraprak për pasagjerin (API)” është pjesë e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit dhe përfshin llojin, numrin, vendin e lëshimit dhe datën e skadimit të çdo dokumenti udhëtimi, shtetësinë, mbiemrin, emrin/emrat tjetër/e tjerë, gjininë, datën e lindjes, linjën e fluturimit, numrin e fluturimit, datën e nisjes, datën e mbërritjes, aeroportin e nisjes, aeroportin e mbërritjes, kohën e nisjes dhe kohën e mbërritjes, si dhe numrin e përgjithshëm të pasagjerëve që transportohen.

15. “Njësia e informacionit të pasagjerit” është struktura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përpunon të dhënat e pasagjerit.

16. “Baza e të dhënave të pasagjerit” është baza e të dhënave, që përmban të gjitha të dhënat e regjistrit të rezervimit të pasagjerit dhe

administrohet nga njësia e informacionit të pasagjerit.

Neni 3

Menaxhimi i integruar i kufirit

1. Për zbatimin e këtij ligji, autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me konceptin e “Menaxhimit të integruar të kufirit”, i cili udhëhiqet nga parimi i solidaritetit dhe bashkëpunimit, në përputhje me kuadrin strategjik të menaxhimit të integruar të kufirit dhe përbëhet nga elementet, si më poshtë:

a) kontrolli kufitar, përfshirë masat e ndërmarra së bashku me të gjitha autoritetet e zbatimit të ligjit për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimit ndërkufitar;

b) analizimi i risqeve për sigurinë e brendshme dhe analizimi i kërcënimeve që mund të ndikojnë funksionimin ose sigurinë e kufijve;

c) bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe agjencive që veprojnë në fushën e kufirit dhe migracionit, kontrollit doganor, kontrollit të ushqimit, kontrollit shëndetësor, si dhe çdo autoritet tjetër, që ka detyra të lidhura me kufirin;

ç) bashkëpunimi me vendet e tjera, në veçanti në vendet fqinje dhe në ato vende të tjera, të cilat janë identifikuar nëpërmjet analizës së riskut, si vende origjine dhe transiti për migracionin e parregullt;

d) masa teknike dhe operacionale, të cilat janë të lidhura me kontrollin kufitar dhe synojnë të parandalojnë migracionin e parregullt dhe të godasin krimin ndërkufitar;

dh) kthimi i shtetasve të huaj që qëndrojnë në mënyrë të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) përdorimi i teknologjisë dhe sistemeve për shkëmbimin e informacionit;

ë) mekanizmi i kontrollit të cilësisë.

2. Menaxhimi i integruar i kufirit nuk i ndryshon kompetencat përkatëse të autoriteteve doganore në fushën doganore, veçanërisht në lidhje me kontrollet, menaxhimin e riskut dhe shkëmbimin e informacionit.

Neni 4

Të drejtat themelore

1. Autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje të plotë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së



Shqipërisë, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventën e Gjenevës të datës 28 korrik 1951, “Për statusin e refugjatëve”, si dhe me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe detyrimet që lidhen me përfitimin e mbrojtjes ndërkombëtare, së bashku me parimin e moskthimit.

2. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar, askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Rojat kufitare, gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, u japin përparësi dhe kujdes të veçantë të miturve, personave me aftësi të veçanta apo kategorive të tjera vulnerabël.

4. Vendimet dhe masat në zbatim të këtij ligji janë proporcionale me objektivat e synuar dhe merren në bazë të shqyrtimit rast pas rasti.

KREU II KONTROLLI KUFITAR

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar

1. Kontrolli kufitar është nën juridiksionin administrativ të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë, që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore, në bashkëpunim me agjencitë e tjera shtetërore, që veprojnë në kufi.

3. Për zbatimin e këtij ligji, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të vendosë dhe të përdorë mjete teknike, përfshirë ato teknologjike video-fotografike të mbikëqyrjes së kufirit, stacionare apo të lëvizshme, qen shërbimi, si dhe të ngrejë pengesa për të parandaluar personat të shmangin kontrollin kufitar apo të kalojnë kufirin shtetëror jashtë pikave të autorizuara të kalimit kufitar dhe për të zbuluar veprat penale.

4. Në pikat e kalimit kufitar, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të fotografojë dhe të regjistrojë imazhe video-fotografike dhe të përdorë pajisje të tjera automatike, për aq sa ato janë të

nevojshme, për të verifikuar identitetin e personave dhe për të parandaluar e për të zbuluar veprat penale, si dhe për të kapur autorët e tyre. Pajisjet instalohen në vende të dukshme dhe publiku informohet për praninë e tyre.

5. Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të zbatojë sisteme të automatizuara të verifikimit kufitar, ku nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike mbledhen të dhëna për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar të automatizuar.

6. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka në dispozicion burime njerëzore, burime financiare, pajisje dhe teknologji të përshtatshme, të nevojshme për kryerjen e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, në mënyrë të tillë që të sigurojë një nivel të efektshëm, të lartë dhe uniform të kontrollit në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në kufi

1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuar të verifikojnë identitetin e personave, subjektin e kontrollit, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen.

2. Rojat kufitare, në kuadër të verifikimit kufitar, duhet t’u japin nëpunësve të doganave apo nëpunësve të çdo autoriteti tjetër përgjegjës që operon në kufirin shtetëror mundësinë e kryerjes së verifikimeve të përbashkëta me ta, kur këta janë të pranishëm gjatë verifikimit kufitar. Rregullat për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar:

a) të verifikojnë:

i. origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit;

ii. në rast dyshimi të arsyeshëm, identitetin e mbajtësit të dokumenteve të udhëtimit ose vizës,



duke krahasuar identifikuesit biometrikë, të depozituar në baza specifike/konkrete që do të aksesohen, duke kufizuar nivelet e aksesit, përveç ADN-së, me personin që po verifikohet;

b) të sekuestrojnë dokumente udhëtimi, kur ekziston dyshim i arsyeshëm se:

i. dokumenti i udhëtimit ose viza të dokumenti i udhëtimit është e falsifikuar ose e rremë;

ii. janë përdorur për të siguruar informacion të rremë për një person.

4. Nëse vërtetohet se një dokument i sekuestruar nuk është objekt i ndonjë mase të parashikuar nga Kodi Penal, u dorëzohet autoriteteve kompetente për aq kohë sa është i nevojshëm sekuestrimi dhe më pas i kthehet personit ose shtetit që ka lëshuar dokumentin.

5. Rojat kufitare për të kryer kontrollin kufitar kanë të drejtë të hyjnë në çdo ngastër toke dhe në të gjithë ujërat, si dhe të drejtojnë automjetet në çdo rrugë, për sa kohë kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt.

7. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë gjithashtu të drejtën t'u refuzojnë daljen personave:

a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi;

b) për të cilët ka një urdhër gjykatë që ndalon daljen nga Republika e Shqipërisë;

c) që duan t'i fshihen ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit apo ekzekutimit të dënimit me burgim;

ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale;

d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën “ç” të kësaj pike;

dh) të cilët gjatë daljes nga Republika e Shqipërisë përdorin dokumentin e një personi tjetër ose dokument të falsifikuar;

e) të cilët janë të regjistruar në dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër dhe gjatë daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë nuk janë të shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit janë regjistruar.

8. Rojat kufitare kanë të drejtë të zbatojnë me forcë masat e përmendura në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, në mënyrë proporcionale dhe si mjet i fundit, pasi janë shteruar të gjitha mjetet e tjera efektive, në raport me situatën specifike dhe vlerësimin e riskut.

Neni 7

Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në brendësi të territorit

1. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë që në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë të marrë masa për të zbuluar të huajt që qëndrojnë ose që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të paligjshme, si dhe të parandalojë, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkufitar.

2. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të verifikojë dhe të intervistojë persona, të kontrollojë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim ndalimin e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit të paligjshëm të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

3. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka gjithashtu të drejtë të ndërmarrë veprime hetimore dhe procedurale në rastet e veprave penale që lidhen me kufirin, përveç atyre veprave që janë përcaktuar të ndiqen posaçërisht nga struktura të tjera të policisë ose agjenci të tjera.

Neni 8

Pikat e kalimit kufitar

1. Një pikë kalimi kufitar hapet dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet e pikave të kalimit kufitar tokësor, vendimi bazohet në akte ndërkombëtare, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në marrëveshje me vendet fqinje ose në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohen gjithashtu vendndodhja dhe kufizime të mundshme për grupe personash, llojin e qarkullimit ose kufizimet gjeografike.

2. Si përjashtim nga pika 1 e këtij neni, titullari vendor i Policisë Kufitare dhe e Migracionit, pas



konsultimit me autoritetin qendror të Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe me autoritetin doganor të zonës përkatëse të juridiksionit, ka të drejtë të nxjerrë urdhër të argumentuar për hapjen e një pike të përkohshme të kalimit kufitar në zonën përkatëse të juridiksionit të tij. Pika e përkohshme e kalimit kufitar funksionon deri në 14 ditë rresht, kur ajo është e nevojshme për sigurimin e zbatimit të projekteve të qarkullimit lokal ndërkufitar, si aktivitet kulturor, turistik, shkencor, sportiv, ushtrim i emergjencave civile, masa për devijim të qarkullimit rrugor ose veprimtari bujqësore apo pyjore. Në urdhrin për hapjen e pikës së përkohshme të kalimit kufitar përfshihen vendndodhja, orari zyrtar, si dhe kufizimet e mundshme për grupe personash, lloji i qarkullimit ose kufizimet gjeografike dhe ky urdhër bazohet në konsultimet me autoritetet lokale, që lidhen me kontrollin kufitar.

3. Shpenzimet, që lindin për hapjen e pikave të përkohshme të kalimit kufitar, të cilat nuk i shërbejnë qarkullimit kufitar të publikut të gjerë, por vetëm disa personave, përballohen nga pala që bën kërkesën për hapjen e pikës së përkohshme të kalimit kufitar.

4. Gjatë lidhjes së marrëveshjes me vendet fqinje ose nxjerrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe gjatë hartimit të urdhrit, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, merren parasysh aspektet e rendit dhe të sigurisë publike, marrëdhëniet ekonomike dhe lidhjet ekzistuese ndërkufitare, qarkullimi i pritshëm dhe kapaciteti i burimeve të përshtatshme njerëzore për të plotësuar me personel pikën e kalimit kufitar, parashikimet doganore apo të aviacionit dhe marrëveshjet ekzistuese dypalëshe.

Neni 9

Pikat e përbashkëta të kalimit kufitar

1. Pikat e përbashkëta të kalimit kufitar hapen dhe përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave mbi bazën e marrëveshjes ndërkombëtare dypalëshe.

2. Marrëveshja me vendet fqinje për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ratifikohet me ligj.

3. Vendndodhja dhe mënyra e funksionimit të pikës së përbashkët të kalimit kufitar parashikohet në marrëveshje.

4. Organizimi i punës, funksionimi dhe zbatimi i verifikimit të përbashkët kufitar, procedurat e punës, përdorimi i përbashkët i pajisjeve, pagesat e shpenzimeve dhe çdo detaj tjetër teknik përcaktohen në protokollin e zbatimit, të miratuar nga palët.

Neni 10

Infrastruktura në pikat e kalimit kufitar

1. Pikat e kalimit kufitar përshtaten në mënyrë të tillë që verifikimet kufitare të mund të kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Operatorët e aeroporteve dhe porteve, si dhe autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve duhet të garantojnë nëpërmjet infrastrukturës së përshtatshme dhe masave organizative që kontrollet kufitare në aeroporte dhe porte të kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Shpenzimet, që rrjedhin nga këto aktivitete, përballohen nga operatorët e aeroporteve dhe porteve, si dhe nga autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve.

Neni 11

Zona e verifikimit kufitar

1. Çdo pikë e kalimit kufitar, në formë rrethore, si dhe përgjatë gjithë vijës së kufirit, në kufijtë tokësorë, ka një zonë të verifikimit kufitar, që është 2 km në brendësi të territorit. Brenda kësaj zone rojat kufitare janë të autorizuar të kryejnë verifikime kufitare sipas kompetencave të dhëna atyre në këtë ligj.

2. Rreth çdo pike të kalimit kufitar caktohet një zonë e sigurisë kufitare, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Brenda zonës së sigurisë kufitare nuk lejohet asnjë ndërtim apo zhvillim i ndonjë aktiviteti privat, përveç atyre, të cilat i shërbejnë mirëfunksionimit të veprimtarisë së agjencive shtetërore, që veprojnë në kufi dhe që ofrojnë shërbime.

4. Zona e verifikimit kufitar në qarkullimin hekurudhor mbulon shinat dhe ambiente të tjera të hekurudhës, nga pika e kalimit kufitar deri në brendësi të vendit, në aq shtrirje sa është e nevojshme për të kryer verifikime kufitare të efektshme.

5. Zona e verifikimit kufitar në aeroporte dhe porte, që janë pika të kalimit kufitar, mbulon gjithë territorin e aeroportit e të portit.



6. Për pikat e kalimit kufitar të vendosura në shtetin fqinj, zona e verifikimit kufitar në shtetin fqinj përcaktohet në marrëveshjen ndërkombëtare dypalëshe, që rregullon pikën e përbashkët të kalimit kufitar. Në marrëveshjen me vendet fqinje autorizohen gjithashtu rojat kufitare që të kryejnë detyrat e tyre në një zonë të përcaktuar në vendin fqinj. Çdo verifikim që kryhet brenda kësaj zone të përcaktuar të pikës së përbashkët të kalimit kufitar konsiderohet të jetë kryer në zonën e kompetencës së autoritetit vendor të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, që ka gjithashtu kompetencën territoriale për pikën e kalimit kufitar.

Neni 12

Tabelat dhe simbolet në pikat e kalimit kufitar dhe në zonën e verifikimit kufitar

1. Pikat e kalimit kufitar, në afërsi të tyre, shënohen me tabela. Tabelat përmbajnë simbolet kombëtare dhe mbishkrimin “Pikë e kalimit kufitar”. Orari zyrtar i pikës dhe kufizimet e mundshme për llojin e qarkullimit paraqiten me tabela shtesë.

2. Nuk vendosen ose nuk ngjiten tabela për:

- a) pikat e kalimit kufitar për trafikun hekurudhor;
- b) pikat e përkohshme të kalimit kufitar;
- c) pikat e kalimit kufitar, që shtrihen në më shumë se 100 metra përgjatë kufirit shtetëror.

3. Në të gjitha rrugët kryesore që të çojnë në kufi, si dhe në porte e aeroporte, zona e verifikimit kufitar shënohet me tabela.

4. Për të lehtësuar mbarëvajtjen e verifikimit kufitar, në pikat ajrore të kalimit kufitar sigurohen korsi të ndara, të shënuara me tabela. Korsi të ndara me tabela të veçanta mund të sigurohen gjithashtu edhe në pikat tokësore dhe detare të kalimit kufitar.

5. Në rast të një çekuilibrimi të përkohshëm të fluksit të qarkullimit, rregullat në lidhje me përdorimin e korsive të ndryshme mund të shmangen, për sa kohë është e nevojshme për të eliminuar këtë çekuilibrim. Vendimi për këtë merret nga roja kufitare më e lartë që është në shërbim në pikën e kalimit kufitar.

6. Tabelat dhe simbolet e përmendura në pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Pronarët e hapësirave, që i shërbejnë qarkullimit kufitar, duhet të lejojnë vendosjen e tabelave dhe tabelave shtesë.

Neni 13

Kalimi i kufirit

1. Kalimi i kufirit shtetëror lejohet vetëm në pikat e autorizuara të kalimit kufitar. Në pikat e kalimit kufitar, që nuk janë të hapura 24 orë, orari zyrtar shpallet në mënyrë të dukshme.

2. Përgjithësisht nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në rastet e forcës madhore ose nëse parashikohet shprehimisht në një marrëveshje ndërkombëtare, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, kufiri shtetëror mund të kalohet në çdo vend dhe në çdo kohë. Autoriteti i parë vendor ose shtetëror, që njihet me ngjarjen, informon pa asnjë vonesë Policinë Kufitare dhe të Migracionit, ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe emergjencat civile, ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.

Neni 14

Verifikimet kufitare

1. Të gjitha lëvizjet ndërkufitare në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i verifikimeve kufitare nga rojat kufitare.

2. Kalimi i kufirit shtetëror në një pikë të kalimit kufitar, ashtu dhe hyrja në rrethana të jashtëzakonshme dhe emergjence në territorin e Republikës së Shqipërisë, me anije ose me avion, jashtë territorit të aeroportit apo portit, të përcaktuar si pikë e kalimit kufitar, detyron personin t'i nënshtrohet verifikimit kufitar.

3. Kushdo që ka synim të kalojë kufirin shtetëror ose që sapo e ka kaluar atë në një pikë të autorizuar të kalimit kufitar, i nënshtrohet verifikimit kufitar dhe është i detyruar që brenda zonës së verifikimit kufitar:

a) të japë informacion nëse ka kaluar ose ka për synim ta kalojë kufirin;

b) të kalojë, pa asnjë vonesë, në korsitë e përcaktuara për verifikimin kufitar në zonën e verifikimit kufitar, si dhe të zbatojë urdhrat për kryerjen në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë të shpejtë të verifikimit kufitar.

4. Në verifikimet kufitare mund të përfshihen mjetet e transportit dhe sendet në zotërim të personave që kalojnë kufirin shtetëror.



Neni 15

Verifikimi kufitar i personave

1. Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga:

a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave, veçanërisht me:

i. bazat kombëtare të të dhënave, që përmbajnë informacion për dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit;

ii. bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit;

iii. bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse. Kur ka dyshime për origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose për identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihen verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit.

2. Të huajt, krahas verifikimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, janë subjekt i verifikimeve tërësore në hyrje dhe në dalje, të cilat konsistojnë në verifikimin e plotësisë së të gjitha kushteve për kalimin e kufirit shtetëror.

3. Verifikimet kufitare tërësore në hyrje përbëhen nga:

a) verifikimi i të huajit, nëse ai posedon, për kalimin e kufirit shtetëror, një dokument udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, të shoqëruar me vizë ose leje qëndrimi, kur kjo kërkohet nga legjislacioni;

b) këqyrja e plotë e dokumentit për ndonjë shenjë falsifikimi, sajimi apo tjetërsimi;

c) shqyrtimi i vulave të hyrjeve/daljeve në dokumentin e udhëtimit, duke i krahasuar me të dhënat në bazat e të dhënave të hyrjeve/daljeve, për të verifikuar nëse i huaji ka tejkaluar afatin e autorizuar të qëndrimit në territorin e vendit;

ç) verifikimi i dokumentacionit për nisjen, destinacionin dhe arsyen e qëndrimit të personit;

d) verifikimi i të huajit nëse ai ka mjete të mjaftueshme financiare për kohën dhe qëllimin e qëndrimit, si dhe për kthimin në vendin e origjinës apo për kalimin transit në një vend të tretë, ku i lejohet të hyjë ose verifikimi se ai është në gjendje t'i sigurojë këto mjete financiare në mënyrë të ligjshme.

4. Verifikimet kufitare tërësore në dalje përbëhen nga:

a) verifikimi nëse personi posedon një vizë të vlefshme, në qoftë se kjo kërkohet, përveçse kur ai mban një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, ose dokumente të tjera që autorizojnë qëndrim apo rihyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) verifikimi nëse personi ka shkelur afatin e lejuar të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në qoftë se ai është subjekt i një afati të limituar qëndrimi.

5. Përfshijmë, shtetasit e Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane, Zvicrës, Andorrës, Monakos dhe San-Marinot, si dhe të huajt që janë familjarë të tyre dhe që gëzojnë të drejtën e Bashkimit Evropian për lëvizje të lirë ose që janë familjarë të shtetasve shqiptarë, në rast se identiteti dhe lidhjet familjare të tyre provohen, i nënshtrohen verifikimit minimal. Përkufizimi i anëtarëve të familjes në ligjin për të huajt është i vlefshëm edhe për këtë ligj.

6. Personat, që janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, në bazë të analizës së riskut dhe në mënyrë josistematike, mund t'i nënshtrohen verifikimit tërësor.

7. Nëse nga rezultatet e verifikimit në vijën e parë konsiderohen të nevojshme verifikime të mëtejshme, personit i kërkohet t'i nënshtrohet verifikimit në vijën e dytë, i cili mund të përfshijë verifikime të hollësishme personale, verifikime të hollësishme të sendeve në posedim dhe inspektime të hollësishme të automjetit.

8. Aty ku janë kushtet, verifikimet e vijës së dytë kryhen në ambiente të përshtatura posaçërisht për këtë qëllim.

9. Të gjithë personat, që janë subjekt i verifikimit në vijën e dytë, informohen me shkrim për qëllimin dhe procedurat që ndiqen gjatë këtij verifikimi, në një gjuhë që e kuptojnë apo që ka arsye për të besuar se e kuptojnë ose në një mënyrë tjetër efektive. Informacioni pasqyron të drejtën që ka personi,



subjekt i verifikimit në vijën e dytë, për të kërkuar emrin ose numrin e identifikimit të rojës kufitare që kryen verifikimin tërësor në vijën e dytë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri shtetëror. Përmbajtja e këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

10. Si përjashtim nga rregullat e përgjithshme të verifikimit kufitar, për kategori të caktuara personash dhe mjeteve transporti zbatohen rregulla të veçanta, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Verifikimi i sendeve dhe mjeteve të transportit

1. Verifikimi i sendeve përfshin sendet personale, që zotëron personi që kalon kufirin shtetëror.

2. Në rast se ka dyshime për sende ose objekte të ndaluara të fshehura ose për të verifikuar identitetin e një personi, roja kufitare i kërkon personit të paraqesë të gjitha sendet që ka në zotërim për të bërë të mundur që objektet të këqyren nga brenda dhe jashtë.

3. Verifikimi i mjeteve të tyre të transportit përfshin inspektimin me sy, nga brenda dhe nga jashtë, të mjeteve të transportit dhe verifikimin në bazat përkatëse të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

4. Objektet ose sendet e tjera, që zbulohen gjatë verifikimit dhe procedurës së inspektimit, të cilat nuk janë objekt i punës së Policisë Kufitare dhe të Migracionit, u dorëzohen autoriteteve doganore ose autoriteteve të tjera përgjegjëse që operojnë në kufi. Procedurat e verifikimit dhe inspektimit zbatohen dhe vendimet në rrjedhim të tyre merren në bashkëpunim me autoritetet e përfshira.

Neni 17

Vulosja e dokumenteve të udhëtimit

1. Dokumentet e udhëtimit të të huajve vulosen rregullisht në hyrje dhe në dalje të kufirit shtetëror. Kurdo që është e mundur, i huaji informohet për këtë detyrim. Specifikisht, vulat për hyrjen dhe daljen vendosen në:

a) dokumentet me vizë të vlefshme, që lejojnë personat të kalojnë kufirin shtetëror;

b) dokumentet, që lejojnë personat të kalojnë kufirin shtetëror, pasi u është lëshuar një vizë në kufi;

c) dokumentet, që lejojnë të kalojnë kufirin shtetëror personat që nuk kanë nevojë për vizë.

2. Nuk vendoset vulë në hyrje ose dalje në:

a) dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Shqipërisë, të Bashkimit Evropian, të Zonës Ekonomike Evropiane, të Zvicrës, të Andorrës, të Monakos dhe të San-Marinos;

b) dokumentet e udhëtimit të kryetarëve të shteteve e të personaliteteve, mbërritja e të cilëve është njoftuar paraprakisht nëpërmjet kanaleve diplomatike;

c) licencat e pilotëve ose certifikatat e anëtarëve të ekuipazhit të avionit;

ç) dokumentet e udhëtimit të marinarëve, brenda zonës së verifikimit kufitar të portit, në të cilin anija e tyre ankorohet;

d) dokumentet e udhëtimit të ekuipazhit dhe pasagjerëve të anijeve turistike, që nuk janë subjekt i verifikimit kufitar;

dh) dokumentet e banorëve kufitarë, që përfitojnë regjim të qarkullimit lokal kufitar;

e) dokumentet e udhëtimit të të huajve, që paraqesin një leje të vlefshme qëndrimi, në përputhje me legjislacionin për të huajt;

ë) dokumentet e udhëtimit të ekuipazhit të trenave të udhëtarëve dhe të mallrave në linjat ndërkombëtare.

3. Dokumentet e udhëtimit të të huajve, që janë anëtarë të familjeve të shtetasve të Republikës së Shqipërisë, të shtetasve të Bashkimit Evropian, të shtetasve të Zonës Ekonomike Evropiane dhe të shtetasve të Zvicrës, Andorrës, Monakos dhe San-Marinos, të cilët nuk paraqesin një leje qëndrimi të vlefshme, duhet të vulosen në hyrje dhe në dalje.

4. Si përjashtim, me kërkesë të të huajt, mund të mos bëhet vendosja e vulës së hyrje-daljes nëse vendosja e saj mund të krijojë vështirësi serioze për personin. Në këtë rast, vula e hyrjes dhe e daljes vendoset në një fletë më vete, ku specifikohen emri dhe mbiemri i personit, si dhe numri i pasaportës. Kjo fletë i dorëzohet shtetasit të huaj. Policia Kufitare dhe e Migracionit mban statistika për këto raste përjashtimore.

5. Formatit dhe specifikimet teknike të vulave, si dhe rregullat praktike për vulosjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 18

Lehtësimi i verifikimeve kufitare

1. Verifikimet kufitare mund të lehtësohen në situata të veçanta dhe të paparashikuara, që sjellin ngarkesë në qarkullim në pikën e kalimit kufitar dhe kur të gjitha burimet, që lidhen me personelin, pajisjet, ambientet dhe organizimin, janë shteruar.

2. Vendimi për lehtësim, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, merret nga roja kufitare më e lartë që është në shërbim në pikën e kalimit kufitar.

3. Lehtësimi i verifikimeve është i përkohshëm, në përputhje me rrethanat justifikuese të tij dhe zbatohet gradualisht.

4. Kur verifikimet kufitare janë të lehtësuara, verifikimet kufitare të lëvizjeve në hyrje, si parim, fitojnë përparësi ndaj verifikimeve kufitare të lëvizjeve në dalje.

5. Në rastet kur verifikimet kufitare janë të lehtësuara, rojat kufitare mund të mos kryejnë regjistrimin, por pas verifikimit të vlefshmërisë së dokumentit dhe të identitetit të mbajtësit, duhet të vulosin dokumentet e udhëtimit të të huajve në hyrje dhe në dalje, siç parashikohet në nenin 17 të këtij ligji.

6. Në pikën e kalimit kufitar mbahen regjistrimet për arsyet, kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit të lehtësimit.

KREU III

RREGULLAT E QARKULLIMIT LOKAL KUFITAR

Neni 19

Zbatimi i qarkullimit lokal kufitar

1. Me qëllim zbatimin e regjimit të qarkullimit lokal kufitar, Këshilli i Ministrave mund të nënshkruajë marrëveshje dypalëshe me vendet fqinje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Qarkullimi lokal kufitar zbatohet vetëm për shtetasit që banojnë jo më larg se 30 km nga kufiri shtetëror dhe 5 km nga pika më e afërt e kalimit kufitar, për të paktën 1 vit, e parashikuar në marrëveshjen dypalëshe me vendet fqinje. Lista e qendrave të banuara do të jetë pjesë integrale e marrëveshjes.

3. Qarkullimi lokal kufitar, përveç pikave të kalimit kufitar, bëhet edhe nëpërmjet vendkalimeve

të veçanta kufitare, të cilat miratohen me marrëveshje, të lidhura vetëm për qarkullimin lokal të kufirit.

Neni 20

Përfashtime

Rregullat e qarkullimit lokal kufitar nuk ndikojnë për rregullat e parashikuara nga legjislacioni, që lidhen me:

- a) qëndrimin afatgjatë të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë;
- b) aksesin dhe ushtrimin e aktivitetit ekonomik të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë;
- c) çështjet doganore dhe tatimore.

Neni 21

Regjimi i qarkullimit lokal kufitar

1. Shtetasit, që jetojnë në zonat kufitare tokësore, mund të kalojnë kufirin tokësor, në përputhje me rregullat e regjimit të qarkullimit kufitar, me kusht që:

- a) të jenë të pajisur me leje të qarkullimit lokal kufitar dhe me një dokument apo dokumente të vlefshme identifikimi ose udhëtimi;
- b) të mos jenë persona, të cilëve u është ndaluar hyrja në Republikën e Shqipërisë;
- c) të mos jenë persona që konsiderohen të jenë kërcënim për sigurinë publike, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetasit e huaj, që jetojnë në zonat e përcaktuara kufitare të vendit fqinj, kanë të drejtë të qëndrojnë në zonat kufitare të Republikës së Shqipërisë, jo më gjatë se 90 ditë, brenda 180 ditëve.

3. Të miturit nën moshën 16 vjeç përjashtohen nga detyrimi për të qenë të pajisur me dokument të vlefshëm identifikimi apo udhëtimi.

4. Të miturit, që për arsye të kushteve lokale frekuentojnë shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga kushti i parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 22

Leja e qarkullimit lokal kufitar

1. Me qëllim zbatimin e regjimit të qarkullimit lokal kufitar, ministria përgjegjëse për menaxhimin e kufirit, nëpërmjet autoriteteve përgjegjëse, garanton pajisjen me leje të qarkullimit lokal kufitar të



shtetasve që banojnë pranë zonës kufitare të vendit me të cilin zbatohet ky regjim, mbi bazën e kërkesës së tyre.

2. Formati dhe përmbajtja e aplikimit miratohet me dakordësinë e palëve në marrëveshje. Aplikimi për t'u pajisur me leje qarkullimi lokal kufitar bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania".

3. Vlefshmëria e lejes së qarkullimit lokal kufitar është e kufizuar vetëm në zonën kufitare dhe ka afat vlefshmërie deri në 5 vjet, por jo më shumë se vlefshmëria e dokumentit të identifikimit apo udhëtimit të banorit kufitar, që aplikon për një leje të tillë.

4. Leja e qarkullimit lokal kufitar anulohet kur banori kufitar i pajisur nuk është më banor i zonës kufitare.

5. Leja e qarkullimit lokal kufitar shfuqizohet në rastet kur lind një nga kushtet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 21 të këtij ligji, kur mbajtësi vepron në mënyrë të përsëritur, në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 21 dhe të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji.

6. Leja e qarkullimit lokal kufitar nuk është dokument identifikimi, përveç rastit të parashikuar në pikën 3 të nenit 21 të këtij ligji.

Neni 23

Përmbajtja, forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit lokal kufitar

1. Leja e qarkullimit lokal kufitar përmban, të paktën:

- a) foton e mbajtësit;
- b) emrin, mbiemrin, datën e lindjes, shtetësinë dhe vendbanimin e mbajtësit;
- c) autoritetin lëshues dhe periudhën e vlefshmërisë;
- ç) zonën kufitare në të cilën mbajtësi autorizohet të lëvizë dhe të qëndrojë;
- d) numrin/numrat e dokumenteve të identifikimit apo udhëtimit, me të cilin/cilat mbajtësi autorizohet të kalojë kufirin.

2. Leja e qarkullimit lokal kufitar përmban njoftimin se mbajtësi i lejes nuk është i autorizuar të lëvizë jashtë zonës kufitare.

3. Forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit kufitar përcaktohen në rregullore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Kushtet për pajisjen me leje të qarkullimit lokal kufitar

1. Leja e qarkullimit lokal kufitar mund të lëshohet për shtetasit që banojnë brenda zonave kufitare, të cilët:

- a) posedojnë një dokument të vlefshëm identifikimi apo udhëtimi;
- b) provojnë se janë banorë të zonës kufitare, pjesë e marrëveshjes së nënshkruar;
- c) nuk janë persona, të cilëve u është ndaluar hyrja në Republikën e Shqipërisë;
- ç) nuk janë persona që konsiderohen të jenë kërcënim për sigurinë publike, shëndetin publik ose për marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Procedurat e aplikimit dhe pajisjes me leje të qarkullimit kufitar përcaktohen në rregullore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Lehtësimi i qarkullimit lokal kufitar

1. Marrëveshjet dypalëshe me vendet fqinje, të parashikuara në pikën 1 të nenit 19, mund të parashikojnë lehtësimin e kalimit të kufirit nëpërmjet:

- a) hapjes së pikave të veçanta të kalimit kufitar për banorët kufitarë;
- b) rezervimit të korsive të veçanta për shtetasit që banojnë brenda zonave kufitare, në pikat e zakonshme të kalimit kufitar; ose
- c) autorizimit të banorëve kufitarë që të kalojnë kufirin e tyre tokësor në vende të përcaktuara, përveç pikave të autorizuara të kalimit kufitar dhe jashtë orarit të caktuar, duke marrë parasysh rrethanat lokale dhe, kur, në raste të veçanta, ka një kërkesë të një natyre të veçantë.

2. Vendet ku do të lejohet kalimi i kufirit tokësor do të parashikohen në marrëveshjen përkatëse.

3. Në rastet kur vendoset lehtësimi i kalimit të kufirit për shtetasit që banojnë brenda zonave kufitare, në përputhje me pikën 1, do të lehtësohet kalimi i kufirit për çdo person, që gëzon të drejtën për lëvizje të lirë, që banon në zonën kufitare në fjalë.

4. Në rastet kur në marrëveshje parashikohet lehtësimi i kalimit të kufirit për banorët kufitarë,



sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni:

a) leja e qarkullimit lokal kufitar duhet të përmbajë, përveç informacionit të parashikuar nga neni 23 i këtij ligji, detajet e vendit dhe rrethanat në të cilat mund të kalohet kufiri tokësor;

b) Policia Kufitare dhe e Migracionit ushtron kontrollë të rastësishme dhe kryen mbikëqyrje të rregullt të kufirit për të parandaluar kalimet e paligjshme të kufirit.

KREU IV MBIKËQYRJA E KUFIRIT

Neni 26 Mbikëqyrja e kufirit

1. Mbikëqyrja e kufirit kryhet me qëllim që të parandalojë kalimet e paautorizuara të kufirit, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkuftar, si dhe të marrë masa ndaj personave që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.

2. Mbikëqyrja midis pikave të kalimit kufitar kryhet nga rojat kufitare. Metodat e veprimit dhe numri i rojave kufitare përshtaten dhe ndryshojnë në raport me rrezikun.

3. Mbikëqyrja kryhet me njësi stacionare ose të lëvizshme, të cilat kryejnë detyrën duke patrulluar ose duke u pozicionuar në vende në bazë të analizës së riskut dhe informacionit policor, me qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së paligjshme ndërkuftare.

Neni 27 Sistemi i mbikëqyrjes së kufirit

1. Në funksion të sigurisë kufitare dhe të shkëmbimit të informacionit, si dhe për bashkëpunimin në fushën e mbikëqyrjes së kufirit, Policia Kufitare dhe Migracionit dhe agjencitë e tjera kombëtare e ndërkombëtare bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me anë të sistemit për mbikëqyrjen e kufirit, i cili përbëhet nga këta komponentë:

- a) Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
- b) situata kombëtare e sigurisë kufitare;
- c) situata rajonale dhe evropiane e sigurisë kufitare;
- ç) rrjeti i komunikimit;

d) informacioni për situatën në zonën kufitare dhe parakuftare;

dh) zbatimi i përbashkët i metodave të mbikëqyrjes.

2. Rregullorja e sistemit të mbikëqyrjes së kufirit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit është strukturë ndërinstitucionale, që ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcaktohet funksionimi i saj.

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit funksionon pa ndërprerje njëzet e katër orë në shtatë ditë të javës dhe ka përgjegjësi:

a) të sigurojë shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe bashkëpunimin e menjëhershëm midis të gjitha autoriteteve kombëtare, me përgjegjësi për mbikëqyrjen e kufirit me të tjera qendra kombëtare të koordinimit të vendeve të tjera, si dhe me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare;

b) të sigurojë shkëmbimin në kohë të informacionit me autoritetet e kërkim - shpëtimit, të zbatimit të ligjit, të azilit dhe të migracionit, në nivel kombëtar;

c) të kontribuojë në një menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve njerëzore;

ç) të hartojë dhe të administrojë raportet e situatës kombëtare të sigurisë kufitare e ato rajonale dhe evropiane të sigurisë kufitare, me ndikim të mundshëm në situatën kombëtare të sigurisë;

d) të mbështesë planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së kufirit;

dh) të koordinojë zbatimin e sistemit kombëtar të mbikëqyrjes së kufirit;

e) të kontribuojë në vlerësimin e rregullt të efekteve kombëtare të aktiviteteve të mbikëqyrjes së kufirit;

ë) të koordinojë masat operationale me autoritetet e vendeve të tjera dhe organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit;



f) të informojë publikun në lidhje me situatën e fluksit dhe kohën e përpunimit të të dhënave të udhëtarëve në pikat e kalimit kufitar;

g) të menaxhojë kufirin në rast konflikti të armatosur, epidemie globale dhe emigrimi masiv.

3. Struktura dhe organika e Qendrës, procedurat standarde të punës së Qendrës, përshkrimet e punës, detyrat funksionale të personelit të Qendrës, format dhe modelet e raportimit miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 29

Vlerësimi i sigurisë në nivel kombëtar dhe rajonal

1. Autoritetet përgjegjëse për garantimin e sigurisë së kufirit bashkëpunojnë për hartimin e vlerësimeve kombëtare dhe rajonale të situatës së sigurisë së kufirit.

2. Vlerësimet kombëtare të situatës së sigurisë së kufirit janë produkt i grumbullimit, vlerësimit, krahasimit, analizës, interpretimit, gjenerimit dhe shpërndarjes së informacionit dhe përmbajnë informacion rreth ngjarjeve dhe incidenteve, informacion operacional dhe raporte analitike.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit përmes strukturave përgjegjëse mbledh, përpunon, vlerëson informacionin operacional të situatës në zonën kufitare e parakufitare dhe çdo informacion tjetër rreth ngjarjeve dhe incidenteve e harton raporte e analiza lidhur me situatën e sigurisë në kufi.

4. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare dhe shkëmben informacion në kuadër të hartimit dhe informimit për raportet e situatës evropiane të sigurisë kufitare.

Neni 30

Rrjeti i komunikimit

1. Policia Kufitare dhe e Migracionit krijojnë dhe mirëmban një rrjet komunikimi që mundëson komunikimin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit me partnerët e saj, me qëllim shkëmbimin e sigurt dhe në kohë të

informacionit. Rrjeti funksionon njëzet e katër orë në shtatë ditë në javë dhe siguron:

a) shkëmbimin në kohë të informacionit në nivel bilateral dhe multilateral;

b) trajtimin, ruajtjen, transmetimin dhe përpunimin e sigurt të informacionit të klasifikuar dhe jo të klasifikuar.

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit shkëmben, përpunon dhe ruan informacione të klasifikuara dhe jo të klasifikuara në rrjetin e komunikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Bashkëpunimi ndërkufitar

1. Autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e integruar të kufirit bashkëpunojnë me autoritetet homologe të vendeve të tjera ose me organizata dhe agjenci ndërkombëtare bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe.

2. Ky bashkëpunim konsiston, por nuk kufizohet vetëm në:

a) shkëmbimin e informacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar dhe të migracionit të parregullt;

b) analizën e përbashkët të rrezikut;

c) trajnimin bazë, të avancuar e të specializuar, si dhe shkëmbimin e eksperiencës;

ç) ndjekjen në gjendjen e flagrancës;

d) survejimin ndërkufitar;

dh) dorëzimin e kontrolluar;

e) operacionet e përbashkëta të kërkimit dhe shpëtimit;

ë) patrullimet e përbashkëta përgjatë kufirit të përbashkët shtetëror;

f) ngritjen e qendrave të bashkëpunimi policor dhe doganor;

g) pjesëmarrjen në operacionet jashtë vendit dhe implementimin e operacioneve të përbashkëta në vendin tonë.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare për të mundësuar koordinimin e aplikimit të përbashkët të metodave të mbikëqyrjes, në mënyrë që të furnizohen qendrat kombëtare të koordinimit me informacion për mbikëqyrje të kufirit dhe në zonën parakufitare.



4. Modalitetet e bashkëpunimit parashikohen në marrëveshje dhe në protokollet përkatëse, si dhe në planet operationale, të hartuara dhe të miratuara bashkërisht.

KREU V ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 32

Përpunimi i të dhënave personale

1. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të mbledhë në mënyrë të drejtpërdrejtë të dhëna personale të personave, që janë subjekt i kontrollit kufitar dhe:

- a) të regjistrojë manualisht të dhëna;
- b) të shënojë manualisht ose elektronikisht të dhënat në një sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave;
- c) të identifikojë dhe të regjistrojë të dhëna për qëllim dhe në kohëzgjatje të verifikimeve kufitare të automatizuara, në rast të përdorimit të pajisjeve për verifikimin kufitar të automatizuar;
- ç) t'i përdorë ato për kërkime, për qëllim të menaxhimit të sigurisë dhe të aktivitetit me autoritetet e sigurisë, që i shërbejnë drejtësisë penale;
- d) në raste dyshimi për një vepër penale, t'i vendosë në dispozicion të një autoriteti tjetër të sigurisë, për qëllime të zbatimit të ligjit, brenda kompetencës ligjore të atij autoriteti.

2. Vendimet për hyrjet dhe daljet depozitohen në sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave.

3. Rregullat për administrimin e të dhënave, të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 33

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Çdo subjekt të dhënash gëzon të drejtën të marrë nga nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave ose struktura përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale pranë Policisë së Kufirit dhe e Migracionit konfirmimin nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar ose jo, dhe, sipas rastit, të ketë akses tek të dhënat personale, në zbatim të

legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Informacioni paraprak për pasagjerin shpërndahet nga njësia e informacionit të pasagjerit pranë autoriteteve përgjegjëse për kontrollin kufitar, me qëllim parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe përmirësimin e kontrollit kufitar.

3. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të drejtën e ankimit dhe kompensimit të dëmit, sipas legjislacionit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 34

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

Policia e Kufirit dhe e Migracionit, lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale të palët e treta, zbaton dispozitat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI SANKSIONET

Neni 35

Sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, për veprimet ose mosveprimet e çdo personi, që:

a) nuk përmbush detyrimet në lidhje me kontrollin kufitar, në përputhje me pikën 1 të nenit 6, të këtij ligji;

b) pengon rojat kufitare të hyjnë për detyra të kontrollit kufitar në zonat e parashikuara në pikën 5 të nenit 6, të këtij ligji;

c) nuk plotëson detyrimet në përputhje me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji në lidhje me kushtet që ndihmojnë për kontroll kufitar të përshtatshëm;

ç) pengon vendosjen, fshin, mbulon ose tjetërsion një nga tabelat e parashikuara në nenin 12 të këtij ligji;

d) kalon kufirin në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji;



dh) nuk plotëson detyrimet në lidhje me informimin e rojës kufitare, në përputhje me pikën 2 të nenit 13 të këtij ligji;

e) nuk paraqitet për verifikim kufitar në pikën e kalimit kufitar në përputhje me pikën 2 të nenit 14, të këtij ligji;

ë) pavarësisht paralajmërimit, refuzon të japë informacion nëse e ka kaluar kufirin shtetëror apo nëse ka qëllim ta bëjë këtë ose jep informacion të pavërtetë, përkundër parashikimeve në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 14, të këtij ligji;

f) synon të kalojë kufirin shtetëror ose ka kryer kalimin e kufirit dhe, megjithëse ka marrë instruksionet, nuk ndjek korsitë e parashikuara për kalimin e kufirit, në përputhje me pikën 3, të nenit 14 të këtij ligji;

g) pavarësisht paralajmërimeve, nuk respekton një vendim të marrë në përputhje me shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji, duke shkaktuar kështu pengesa dhe vonesa në verifikimin kufitar ose vonesë për mjetet e transportit, që kalojnë kufirin sipas një orari të caktuar.

2. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat “a”, “ç” dhe “f” të pikës 1 të këtij neni, kur kryhen nga persona fizikë, dënohen me gjobë nga 5 000 deri 50 000 lekë.

3. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “ë” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni, kur kryhen nga persona fizikë, dënohen me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.

4. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni, gjobiten përkatësisht me trefishin e shumë së parashikuar për personat fizikë, në rast të kryerjes së tyre nga personat juridikë ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë.

5. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni, gjobiten përkatësisht me pesëfishin e shumë së parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, për personat fizikë ose me pesëfishin e parashikimit të pikës 4 të këtij neni në rast se personi i kryen ato duke përdorur mjete lundrimi ose fluturimi.

Neni 36

E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i gjobave

1. Gjocat e parashikuara në këtë ligj vendosen nga rojat kufitare dhe janë titull ekzekutiv.

2. E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i sanksioneve të parashikuara në këtë ligj zbatohen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Dispozita kalimtare

1. Kufizimet e qarkullimit ndërkuftar, që rrjedhin nga dispozita të tjera për rrugë të caktuara për transportin hekurudhor, ajror dhe me mjete lundruese, nuk ndikohen nga dispozitat e neneve 8 dhe 12 të këtij ligji.

2. Pikat e kalimit kufitar dhe zonat transit, të cilat janë hapur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë pika kalimi kufitar dhe zona transit sipas këtij ligji. Lista e të gjitha pikave të kalimit kufitar dhe zonave transit të hapura, ekzistuese përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet brenda 2 muajve, në rast ndryshimi.

3. Pikat e kalimit kufitar, të përmendura në pikën 2 të këtij neni, nga hyrja në fuqi e këtij ligji pajisen me tabela të posaçme, siç përcaktohet në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 38

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 11, pika 2; 12, pika 6; 15, pika 10; 17, pika 5; 23, pika 3; 24, pika 2; 27, pika 2, dhe 28, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të pikës 3 të nenit 32 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 9 të nenit 15 të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për bujqësinë të nxjerrin urdhrin



e përbashkët në zbatim të pikës 3 të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 39
Shfuqizime

Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 217, datë 7.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 217, datë 7.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM
Nr. 374, datë 2.7.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 150, DATË 6.3.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIT RURAL, PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të neneve 40, pika 5, e 41, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2025”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) mbështetjen e investimeve për rritjen e kapaciteteve prodhuese në ferma, përpunimin / tregtimin e produkteve bujqësore, si dhe zhvillimin e agroturizmit dhe të akuakulturës.”.

2. Në pikën 2.3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përfituesve të financimit nga masat e mbështetjes së investimeve pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së pagesës së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka.”.

3. Pas pikës 2.3 shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.4. Mbështetje për investime për:

a) ndërtimin e serrave diellore të reja për perime, luleshtrydhe dhe rrush tavoline, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes, me sipërfaqe minimale 0.2 ha dhe sipërfaqe maksimale 2 ha.



Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se:

- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve;
- 8 000 000 (tetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë;
- 4 000 000 (katër milionë) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

b) mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë/ha.

Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që instalojnë sistemet e ujitjes me pika.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

c) rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha.

ç) sistemet e ujitjes me pika në pemëtore, ullishte, agrume dhe vreshta ekzistuese. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 10 ha.

d) ndërtimin e ambienteve të reja për mbarështimin e kafshëve dhe të stabilimenteve për rritjen e shpendëve, përfshirë pajisjet/sistemet e nevojshme, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imëta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) shpendë.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt.

dh) mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore e blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

e) linja/makineri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit në

50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 7 500 000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë për subjekt.

ë) investime në agroturizëm me një masë përfitimi në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë) për subjekt.

f) akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrijetat). Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt.

Fondi total për mbështetje për investime të jetë në vlerën 2 (dy) miliardë lekë dhe të përdoret për vitin 2025 deri në 537,8 milionë lekë të akorduara në programin buxhetor 04250, “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”, në shpenzime korrente, duke vijuar plotësimin e vlerës së plotë në buxhetin e vitit 2026, si pjesë e PBA-së 2026–2028.”.

II. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 2, datë 26.6.2025

PËR METODOLOGJINË E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE STATISTIKORE KOMBËTARE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Në bazë të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, pika 15, dhe nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, me qëllim mbledhjen dhe raportimin në mënyrë të unifikuar të statistikave të sistemit të drejtësisë sipas standardeve dhe metodologjive të CEPEJ-së,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave statistikore kombëtare të sistemit të



drejtësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Urdhri nr. 250, datë 15.4.2019, i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formateve të mbledhjes së të dhënave statistikore nga Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, dhe udhëzimi nr. 4, datë 15.4.2019, i ministrit të Drejtësisë “Për plotësimin e të dhënave statistikore”, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategji në Fushën e Drejtësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe strukturat e tjera të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë për ta mbështetur sipas nevojës në zbatimin e këtij udhëzimi.

4. Ngarkohet sektori i Arkiv-protokollit dhe Drejtoria e Politikave dhe Strategji në Fushën e Drejtësisë për shpërndarjen dhe njoftimin e këtij udhëzimi.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

UDHËZUES EVIDENCASH STATISTIKORE MINISTRIA E DREJTËSISË

Pasqyra e lëndës

1. Evidenca statistikore e çështjeve penale për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

2. Evidenca statistikore për persona të gjykuar të rritur (formulari nr. 2)

3. Evidenca statistikore për persona të gjykuar të mitur (formulari nr. 3)

4. Evidenca statistikore e çështjeve penale ushtarake (formulari nr. 4)

5. Evidenca statistikore për persona të gjykuar – ushtarakë (formulari nr. 5)

6. Evidenca statistikore e çështjeve penale për gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (formulari nr. 1)

7. Evidenca statistikore e çështjeve civile për gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (formulari nr. 2)

8. Evidenca statistikore për çështjet civile për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (formulari nr. 6)

9. Evidenca statistikore për ngarkesën e gjyqtarëve (formulari nr. 7)

10. Evidenca statistikore për seancat paraprahe (formulari nr. 8)

11. Evidenca statistikore për korrupsionin dhe krimin e organizuar në kuadër të e-platformës (formulari nr. 9)

12. Evidenca statistikore për çështjet administrative për gjykatat administrative të shkallës së parë (formulari nr. 1)

13. Evidenca statistikore e çështjeve administrative për gjykatën administrative të apelit (formulari nr. 1)

14. Evidenca statistikore e çështjeve penale për gjykatën e lartë (formulari nr. 1)

15. Evidenca statistikore e çështjeve civile për gjykatën e lartë (formulari nr. 2)

16. Evidenca statistikore e çështjeve administrative për gjykatën e lartë (formulari nr. 3)

17. Evidenca statistikore për treguesit e efciencës në gjykatat e të tria niveleve nga këshilli i lartë gjyqësor (formulari nr. 1)

18. Evidenca statistikore mbi strukturën dhe shpërndarjen e magjistratëve në të gjitha gjykatat, bazuar në të dhënat e këshillit të lartë gjyqësor (formulari nr. 2)

19. Evidenca statistikore për përbërjen e strukturës faktike dhe organizative në të gjitha prokuroritë nga këshilli i lartë i prokurorisë (formulari nr. 1)

20. Evidenca statistikore për dinamikën e procedimeve nga SPAK-u (formulari nr. 1)

21. Evidenca statistikore për kallëzimet dhe referimet në SPAK për veprat penale (formulari nr. 2)

Hyrje

- Në kuadër të përpjekjeve për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe përmirësimin e qeverisjes institucionale në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë në përputhje me ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar ka hartuar këtë **udhëzues për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore të sistemit të drejtësisë**, si një instrument të domosdoshëm për standardizimin dhe unifikimin e statistikave në fushën e drejtësisë.

- Udhëzuesi përcakton një metodologji të qartë për mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave statistikore që lidhen me funksionimin e gjykatave dhe institucioneve të tjera të drejtësisë. Ai synon të mbështesë vendimmarrjen strategjike dhe menaxhimin e brendshëm institucional përmes



një pasqyre të plotë dhe të krahasueshme të treguesve të performancës, si dhe të lehtësojë përmbushjen e detyrimeve për raportim kombëtar dhe ndërkombëtar, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

- Ky udhëzues zbatohet nga të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë dhe në mënyrë të veçantë, ai u drejtohet: Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Lartë, Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit, Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.

- Udhëzuesi ofron tabela të standardizuara, të cilat janë hartuar për të siguruar uniformitetin dhe qartësi në mënyrën se si raportohen të dhënat mbi çështjet penale, civile dhe administrative. Këto tabela janë strukturuar sipas kompetencës dhe shkallës së gjykatave dhe përmbajnë të dhëna mbi ngarkesën e punës së gjyqtarëve, prurjet e çështjeve të reja, kohëzgjatjen e shqyrtimit, ankimimet, çështjet që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe tregues të tjerë kyç të performancës gjyqësore. Për më tepër, udhëzuesi përkufizon në mënyrë të saktë të gjithë termat teknike të përdorur në këto tabela, duke mundësuar një interpretim të njëtrajtshëm në të gjitha institucionet.

- Një aspekt i veçantë i këtij udhëzuesi është mbledhja e të dhënave kyçe esenciale për vlerësimin e kapaciteteve institucionale dhe përcaktimin e nevojave për ndërhyrje apo reformë si: **ngarkesa mesatare e gjyqtarëve, norma e eficiencës, raporti i qarkullimit të çështjeve, koha për përfundimin e një çështjeje, norma e zgjidhjes së çështjeve, gjendja e backlog-ut, vjetërsia e çështjeve** etj. Të gjitha këto janë.

- Në thelb, ky udhëzues përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi statistikor modern dhe të integruar në fushën e drejtësisë. Ai kontribuon në profesionalizimin e administrimit gjyqësor, mbështet vendimmarrjen e bazuar në evidencë dhe forcon besimin e publikut në funksionimin e drejtë dhe efikas të institucioneve të drejtësisë. Me miratimin dhe zbatimin e këtij

udhëzuesi, krijohet një bazë solide për analizën objektive të performancës, për përmirësimin e politikave publike në fushën e drejtësisë dhe për rritjen e përputhshmërisë me parimet e sundimit të ligjit dhe integritetit evropian.

- Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata Administrative të Apelit, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Lartë, raportojnë në mënyrë elektronike dhe shkresore deri në datën 15 të muajit të katërt pasardhës të dhënat 3-mujore dhe të dhënat vjetore deri në datën 25 të muajit janar të vitit pasardhës, pranë strukturës përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë.

- Prokuroria e Posaçme, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës, dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, dorëzojnë raportimin periodik çdo gjashtë muaj (gjysmëvjetor), po ashtu brenda datës 15 të muajit të katërt pasardhës të periudhës përkatëse dhe raportimin vjetor deri më datë 25 janar të vitit pasardhës.

- Të dhënat statistikore të raportuara nga institucionet e përfshira në këtë udhëzim do të shërbejnë si bazë për hartimin e Vjetarit Statistikor të Sistemit të Drejtësisë, të publikuar nga Ministria e Drejtësisë. Ato do të përdoren gjithashtu për raportime në kuadër të zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, për raportimet pranë CEPEJ-së, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian.

A. PËR ÇËSHTJET PENALE (FORMULARI NR. 1)

1. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE PENALE PËR GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

- Në kolonën 1 do të përcaktohet neni përkatës i Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë sanksione penale.

Në këtë mënyrë vazhdohet me radhë për të gjitha çështjet që ka pasur gjykata gjatë tre muajve. Duhet pasur parasysh që në ndjekjen rendore të dispozitave të Kodit Penal, si dhe të Kodit Penal Ushtarak, të bëhet ndarja e çështjeve sipas karakterit të tyre, duke grumbulluar shumën për krimet dhe kundërvajtjet



penale, penale ushtarake, për ato Gjykata që kanë një kompetencë të tillë.

Në fund bëhet shuma totale e veprave penale.

Krahas neneve përkatës të Kodit Penal, të cilat janë të ndara në krime dhe kundërvajtje, sipas këtij udhëzimi, do të paraqiten në këtë evidencë edhe të gjitha rastet që kanë qenë dhe janë objekt gjykimi penal për krime ose kundërvajtje të parashikuara në ligje të tjera, si p.sh., ligji nr. 8663, datë 19.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 NT”, Kodi Zgjedhor, ligji “Për shoqëritë tregtare”, ligji nr. 9669, ligji nr. 9662, ligji nr. 8017 etj.

DINAMIKA E ÇËSHTJEVE

- Në kolonën nr. 2, **“çështje të pambyllura”**, shënohet numri i atyre çështjeve që në fund të 3-mujorit të mëparshëm kanë rezultuar të papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fillim të periudhës. Ky arsyetim do të mbahet parasysh edhe në rastin e plotësimit të evidencës vjetore.

- Në kolonën nr. 3, **“çështjet të ardhura të reja”**, shënohen të gjitha çështjet e regjistruara për gjykim.

- Në kolonën nr. 4, **“çështjet e ardhura për rigjykim”**, shënohen ato çështje të cilat janë prishur dhe kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

- Në kolonën nr. 5, shënohen **“çështjet e ardhura pas rihetimit”**.

- Në kolonën nr. 6, **“gjithsej”**, shënohet shuma që del nga mbledhja e kolonave **2+3+4+5**.

MËNYRA E PËRFUNDIMIT

- Në kolonën nr. 7 shënohen çështjet për të cilat është **“vendosur fajësia”**.

- Në kolonën nr. 8 shënohen çështjet për të cilat është **“vendosur pafajësia”**.

- Në kolonën nr. 9 shënohen **“çështjet për të cilat është vendosur pushimi”**.

- Në kolonën nr. 10, shënohen çështjet për të cilat gjykata vendos **“kalimin e akteve prokurorit për plotësim”**.

- Në kolonën nr. 11, shënohen ato çështje për të cilat është **“vendosur moskompetenca”**.

- Në kolonën nr. 12, **“çështjet e përfunduara”**, shënohet shuma që del nga mbledhja e kolonave **7+8+9+10+11**.

- Kolona Nr. 13, e cila përmban numrin e çështjeve të mbetura **“pa përfunduara”** ose që janë në pritje të gjykimit në fund të periudhës, llogaritet

duke zbritur nga kolona nr. 6 kolonën nr. 12 (**12 = 7+8+9+10+11**).

KOHËZGJATJA E ÇËSHTJEVE TË GJYKUARA

Afati i përfundimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 14), **6 muaj – 1 vit** (kolona 15), **1–2 vjet** (kolona 16) dhe **mbi 2 vjet** (kolona 17).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 7, 8, 9, 10, 11, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 6, pra $6 = (7+8+9+10+11)$.

ANKIMIMET

- Në kolonat 18, 19 do të shënohen apelet përkatëse të prokurorit dhe të të pandehurit. Duhet pasur kujdes në plotësimin e kolonës nr. 20, **“shuma e apelimeve”**, pasi jo gjithmonë ajo është rezultat i shumës së të dhënave të kolonës nr. 18 dhe 19. Për shembull, paraqesim rastin kur për të njëjtën vepër penale, apelojnë njëkohësisht prokurori edhe i pandehuri. Ky arsyetim qëndron edhe në rastin e rekurseve për kolonat nr. 21 e nr. 22.

KËRKESAT PENALE

- Në kolonën nr. 25, **“arrest me burg”**, shënohen rastet kur për të pandehurin është marrë masa e sigurimit arrest në burg me ose pa afat.

- Në vazhdimin e kolonave të tjera, do të shënohen të gjitha rastet sipas përcaktimit të shënuar në kokën e kolonës.

- Te kolona nr. 35, **“Kërkesa të tjera penale”**, do të shënohen të gjitha ato kërkesa, të cilat parashikohen në nenet e mëposhtme 46/3, 106, 110, 114, 147, 198, 202, 204, 205, 208, 210, 212, 217, 222, 242, 243, 247, 264, 269, 271, 291, 317, 325, 329, 459, 469, 477, 515, 517, 520-523, të Kodit të Procedurës Penale.

- Kolona nr. 36, është rezultat i shumës së kolonave

25+26+27+28+29+30+31+32+33+34+35.

2. EVIDENCA STATISTIKORE PËR PERSONA TË GJYKUAR TË RRITUR (FORMULARI NR. 2)

- Në kolonën nr. 1, shënohet numri i personave **“të dënuar”**, në kolonën nr. 2, numri i personave të deklaruar **“të pafajshëm”** dhe në kolonën nr. 3, numri i personave për të cilët është vendosur **“pushimi i çështjes”**.

- Në kolonën nr. 4, shënohet shuma e personave të gjykuar d.m.th. shuma e kolonave **1+2+3**.



- Në kolonën nr. 5, shënohen sesa nga personat e dënuar, janë të **gjinisë femërore**.

- Në kolonën nr. 6, shënohen **“përsëritës në përgjithësi”**, kurse në kolonën nr. 7, **“përsëritës për të njëjtën vepër penale”**.

- Në kolonën nr. 8, shënohen ata të dënuar që janë **“pa arsim”**, kurse kolona nr. 9, shënohen të dënuarit e tjerë **“me arsim”**.

- Të dhënat e kolonave nr. 5, 6, 7, 8, 9, duhet të nxirren nga kolona nr. 1, **e personave të dënuar**.

MASA E DËNIMIT

Masa e dënimit është kategorizuar në këtë mënyrë:

- **“me gjobë”** (kolona nr. 10), dënim me burg **“deri në 2 vjet”** (kolona 11), **“2-5 vjet”** (kolona 12), **“aplikimi i nenit 58”** (kolona 13), **“aplikimi i nenit 59”** (kolona 14), **“aplikimi i nenit 59/a”** (kolona 15), **“aplikimi i nenit 63”** (kolona 16), **“aplikimi i nenit 64”** (kolona 17), **“mjekim i detyruar”** (kolona 18), **“5-10 vjet”** (kolona 19), **“10-25 vjet”** (kolona 20), **“25-35 vjet”** (kolona 21) dhe **“burgim i përjetshëm”** (kolona 22).

- Shuma e kolonave për masën e dënimit duhet të përputhet me numrin e të dënuarve të shënuar në kolonën nr. 1 (*e cila dubet të jetë e njëjtë ose me e madhe me shumën përfundimtare të kolonës nr. 7 “me vendim fajësie” të Evidencës Statistike të Çështjeve Penale dhe në asnjë rast më e vogël*).

3. EVIDENCA STATISTIKORE PËR PERSONA TË GJYKUAR TË MITUR (FORMULARI NR. 3)

- Në kolonën Nr. 1, shënohet numri i personave **“të dënuar”**, në kolonën nr. 2, numri i personave të deklaruar **“të pafajshëm”** dhe në kolonën nr. 3, numri i personave për të cilët është vendosur **“pushimi i çështjes”**.

- Në kolonën nr. 4, shënohet shuma e personave të gjykuar d.m.th. shuma e kolonave **1+2+3**.

- Në kolonën nr. 5, shënohen sesa nga personat e dënuar, janë të **gjinisë femërore**.

- Në kolonën nr. 6, shënohen **“përsëritës në përgjithësi”**, kurse në kolonën nr. 7, **“përsëritës për të njëjtën vepër penale”**.

- Në kolonën nr. 8, shënohen ata të dënuar që janë **“pa arsim”**, kurse kolona nr. 9, shënohen të dënuarit e tjerë **“me arsim”**.

- Të dhënat e kolonave nr. 5, 6, 7, 8, 9, duhet të nxirren nga kolona nr. 1, **e personave të dënuar**.

MASA E DËNIMIT

Masa e dënimit është kategorizuar në këtë mënyrë:

- **“me gjobë”** (kolona nr. 10), dënim me burg **“deri në 2 vjet”** (kolona 11), **“2-5 vjet”** (kolona 12), **“aplikimi i nenit 39”** (kolona 13), **“kufizimi i lirisë”** (kolona 14), **“aplikimi i nenit 59/a”** (kolona 15), **“aplikimi i nenit 63”** (kolona 16), **“përmbushja e detyrimeve të caktuara”** (kolona 17), **“mjekim i detyruar”** (kolona 18), **“5-10 vjet”** (kolona 19), **“10-25 vjet”** (kolona 20).

- Shuma e kolonave për masën e dënimit duhet të përputhet me numrin e të dënuarve të shënuar në kolonën nr. 1 (*e cila dubet të jetë e njëjtë ose më e madhe me shumën përfundimtare të kolonës nr. 7 “me vendim fajësie” të Evidencës Statistike të Çështjeve Penale dhe në asnjë rast më e vogël*).

Plotësimi i formularëve i ndarë në krime dhe kundërvajtje penale, do të bëhet si më poshtë:

- Dispozitat që do të përfshihen në këtë evidencë janë ato të parashikuara në Kodin Penal, të cilat klasifikohen në dy kategori kryesore: krime dhe kundërvajtje penale, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. Gjithashtu, në evidencë do të përfshihen edhe të gjitha rastet që kanë qenë ose janë objekt gjykimi penal për vepra të parashikuara në legjislacionin penal jashtë Kodit Penal, përfshirë ligje të veçanta materiale. Për veprat penale të parashikuara jashtë Kodit Penal, ndarja në krime dhe kundërvajtje do të bëhet mbi bazën e kriterit të maksimumit të dënimit të parashikuar nga ligji, në përputhje me standardin ligjor për klasifikimin përkatës.

4. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE PENALE USHTARAKE (FORMULARI NR. 4)

- Në kolonën 1 do të përcaktohet neni përkatës i Kodit Penal Ushtarak ose ligjeve të tjera që parashikojnë sanksione penale.

Në këtë mënyrë vazhdohet me radhë për të gjitha çështjet që ka pasur gjykata gjatë tre muajve. Duhet pasur parasysh që në ndjekjen rendore të dispozitave të Kodit Penal Ushtarak, të bëhet ndarja e çështjeve sipas karakterit të tyre, duke grumbulluar shumën për krimet dhe kundërvajtjet penale ushtarake, për ato Gjykata që kanë një kompetencë të tillë.

Në fund bëhet shuma totale e veprave penale.

DINAMIKA E ÇËSHTJEVE

- Në kolonën Nr. 2, **“çështje të pambyllura”**, shënohet numri i atyre çështjeve që në fund të 3-mujorit të mëparshëm kanë rezultuar të pa



përfunduara/ në pritje të gjykimit. Ky arsyetim do të mbahet parasysh edhe në rastin e plotësimit të evidencës vjetore.

- Në kolonën nr. 3, **“çështjet të ardhura të reja”**, shënohen të gjitha çështjet e regjistruar për gjykim.

- Në kolonën nr. 4, **“çështjet e ardhura për rigjykim”**, shënohen ato çështje të cilat janë prishur dhe kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

- Në kolonën nr. 5, shënohen **“çështjet e ardhura pas rihetimit”**.

- Në kolonën nr. 6, **“shuma e çështjeve për gjykim”**, shënohet shuma që del nga mbledhja e kolonave **2+3+4+5**.

ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA

- Në kolonën nr. 7 shënohen çështjet për të cilat është **“vendosur fajësia”**.

- Në kolonën nr. 8 shënohen çështjet për të cilat është **“vendosur pafajësia”**.

- Në kolonën nr. 9 shënohen **“çështjet për të cilat është vendosur pushimi”**.

- Në kolonën nr. 10, shënohen çështjet për të cilat gjykata vendos **“kalimin e akteve prokurorit për plotësim”**.

- Në kolonën nr. 11, shënohen ato çështje për të cilat është **“vendosur moskompetenca”**.

- Në kolonën nr. 12, **“çështjet e përfunduara”**, shënohet shuma që del nga mbledhja e kolonave **7+8+9+10+11**.

- Kolona nr. 13, e cila përmban numrin e çështjeve të mbetura **“pa përfunduara”**, llogaritet duke zbritur nga kolona nr. 6 kolonën nr. 12 (shumën e kolonave **7+8+9+10+11**).

SHPEJTËSIA NË GJYKIM

- Afati i përfundimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 14), **6 muaj – 1 vit** (kolona 15), **1-2 vjet** (kolona 16) dhe **mbi 2 vjet** (kolona 17).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 7, 8, 9, 10, 11, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 6, pra $6 = (7+8+9+10+11)$.

ANKIMIMET

- Në kolonat 18, 19 do të shënohen apelet përkatëse të prokurorit dhe të të pandehurit. Duhet të kihet kujdes në plotësimin e kolonës nr. 20, **“shuma e apeliimeve”**, pasi jo gjithmonë ajo është rezultat i shumës së të dhënave të kolonës nr. 18 dhe

19. Për shembull, paraqesim rastin kur për të njëjtën vepër penale, apelojnë njëkohësisht prokurori edhe i pandehuri. Ky arsyetim qëndron edhe në rastin e rekurseve për kolonat nr. 21 e nr. 22.

KËRKESAT PENALE

- Në kolonën nr. 25, **“arrest me burg”**, shënohen rastet kur për të pandehurin është marrë masa e sigurimit arrest në burg me ose pa afat.

- Në vazhdimin e kolonave të tjera, do të shënohen të gjitha rastet sipas përcaktimit të shënuar në kokën e kolonës.

- Te kolona nr. 35, **“Kërkesa të tjera penale”**, do të shënohen të gjitha ato kërkesa, të cilat parashikohen në nenet e mëposhtme 46/3, 106, 110, 114, 147, 198, 202, 204, 205, 208, 210, 212, 217, 222, 242, 243, 247, 264, 269, 271, 291, 317, 325, 329, 459, 469, 477, 515, 517, 520-523, të Kodit të Procedurës Penale. Kolona nr. 34, është rezultat i shumës së kolonave **25+26+27+28+29+30+31+32+33**.

5. EVIDENCA STATISTIKORE PËR PERSONA TË GJYKUAR – USHTARAKË (FORMULARI NR. 5)

- Në kolonën nr. 1, shënohet numri i personave **“të dënuar”**, në kolonën nr. 2, numri i personave të deklaruar **“të pafajshëm”** dhe në kolonën nr. 3, numri i personave për të cilët është vendosur **“pushimi i çështjes”**.

- Në kolonën nr. 4, shënohet shuma e personave të gjykuar d.m.th. shuma e kolonave **1+2+3**.

- Në kolonën nr. 5, shënohen sesa nga personat e dënuar, janë të **gjinisë femërore**.

- Në kolonën nr. 6, shënohen **“përsëritës në përgjithësi”**, kurse në kolonën Nr.7, **“përsëritës për të njëjtën vepër penale”**.

- Në kolonën nr. 8, shënohen ata të dënuar që janë **“pa arsim”**, kurse kolona Nr.9, shënohen të dënuarit e tjerë **“me arsim”**.

- Të dhënat e kolonave nr. 5, 6, 7, 8, 9, duhet të nxirren nga kolona Nr.1 **“e personave të dënuar”**.

MASA E DËNIMIT

Masa e dënimit është kategorizuar në këtë mënyrë:

- **“me gjobë”** (kolona nr. 10), dënim me burg **“deri në 2 vjet”** (kolona 11), **“2-5 vjet”** (kolona 12), **“lirim nga ushtria”** (kolona 13), **“me degradim”** (kolona 14), **“dënime plotësuese”** (kolona 15), **“5-10 vjet”** (kolona 16), **“10-25 vjet”** (kolona 17) dhe **“burgim i përjetshëm”** (kolona 18).

- Shuma e kolonave për masën e dënimit duhet të përputhet me numrin e të dënuarve të shënuar në



kolonën nr. 1 (e cila duhet të jetë e njëjtë ose me e madhe me shumën përfundimtare të kolonës nr. 7 **“me vendim fajësie”** të Evidencës Statistike të Çështjeve Penale Ushtarake dhe **në asnjë rast më e vogël**).

Plotësimi i formularëve i ndarë në krime ushtarake dhe kundërvajtje penale ushtarake, do të bëhet si më poshtë:

KRIMET USHTARAKE

- Në këtë evidencë do të përfshihen veprat penale të cilat, sipas përcaktimeve të Kodit Penal Ushtarak dhe në përputhje me udhëzimet përkatëse, klasifikohen si krime ushtarake. Këto përfshijnë vepra që për nga natyra dhe rrezikshmëria shoqërore përbëjnë shkelje të rënda të rendit dhe disiplinës ushtarake, duke cenuar funksionimin, sigurinë apo integritetin e strukturave të Forcave të Armatosura.

KUNDËRVAJTJET PENALE USHTARAKE

- Në këtë kategori përfshihen veprat penale që, megjithëse të sanksionuara në Kodin Penal Ushtarak, karakterizohen nga një shkallë më e ulët e rrezikshmërisë dhe cilësohen si kundërvajtje ushtarake. Ato lidhen kryesisht me sjellje që cenojnë disiplinën apo zbatimin e detyrave ushtarake, por pa pasur ndikim të thellë në rendin ushtarak apo sigurinë kombëtare.

6. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE PENALE PËR GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjelli gjykata e apelit për çështjet penale pasqyrohet: në kolonën nr. a, Gjykatën nga e cila vjen çështja.

- Në kolonën nr. 1, **“çështjet e pambyllura”**, shënohen të dhënat të cilat përbëjnë numrin e atyre çështjeve që në fund të periudhës së mëparshme ishin të papërfunduara/ në pritje të gjykimit.

- Në kolonën nr. 2, **“çështjet e ardhura”** gjatë 3/mujorit dhe në kolonën nr. 3, **“gjithsej”** çështje për gjykim, të bëhet rakordimi sipas barazimit: (3 = 1+2),

- **“Përfundimi”** përcaktohet nga: **“shqyrtuar”**, **“në dorë”** dhe **“pezulluar”**. Shuma e kolonave 4, 5, 6, duhet të jetë e barabartë me të dhënat e kolonës 3 (gjithsej çështjet).

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”** përcaktohet nga: **“moskompetencë lëndore”**, **“lënie në fuqi”**, **“prishur (pushuar)”**, **“prishur (pafajësi)”**, **“kthyer për rigjykim”**, **“kthyer për rihetim”**, **“mospranim i ankimit”**, **“gjykuar si shkallë e parë”** dhe **“ndryshuar”**.

- Kolonat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 duhet të japin shumën e çështjeve të shqyrtuara të kolonës nr. 4.

- Te **“llojet e ndryshimeve”** duhet të shënohen të dhënat sipas kolonave:

- Kolona nr. 16 të dhëna **“lidhur me dënimin”**, kolona 17 **“rikualifikim”** dhe kolona 18 **“padia civile”**.

- Kolonat 16, 17, dhe 18 duhet të japin shumën e kolonës 15 **“ndryshuar”**.

AFATI I SHQYRTIMIT

Afati i shqyrtimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 194), **6 muaj – 1 vit** (kolona 20), **mbi 1 vit** (kolona 21).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 19, 20, 21, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 4, pra 4 = (19, 20, 21).

7. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE CIVILE PËR GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM (FORMULARI NR. 2)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellin gjykatat e apelit për çështjet civile pasqyrojnë: në kolonën nr. a, Gjykatën nga e cila vjen çështja.

- Në kolonën nr. 1, **“çështjet e pambyllura”**, shënohen të dhënat të cilat përbëjnë numrin e atyre çështjeve që në fund të periudhës së mëparshme ishin të papërfunduara/ në pritje të gjykimit.

- Në kolonën nr. 2, **“çështjet e ardhura”** gjatë 3/mujorit dhe në kolonën nr. 3, **“gjithsej”** çështje për gjykim, të bëhet rakordimi sipas barazimit: (3 = 1+2).

- **“Përfundimi”** përcaktohet nga: **“shqyrtuar”** dhe **“në dorë”**. Shuma e kolonave 4, 5, duhet të jetë e barabartë me të dhënat e kolonës 3 (gjithsej çështjet).

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”** përcaktohet nga: **“moskompetencë lëndore”**, **“lënie në fuqi”**, **“prishur për rigjykim”**, **“prishur e gjykuar në fakt”**, **“pushuar dhe rrëzuar”**, **“pushuar dhe hequr dorë”**, **“ndryshuar”** dhe **“ndryshuar për shkaqe të tjera”**.

- Kolonat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, duhet të japin shumën e çështjeve të shqyrtuara të kolonës Nr. 4, pra 4 = (6+7+8+9+10+11+12+13).



AFATI I SHQYRTIMIT

Afati i shqyrtimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 14), **6 muaj – 1 vit** (kolona 15), **mbi 1 vit** (kolona 16).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 14, 15 dhe 16, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 4, pra $4 = (14+15+16)$.

B. EVIDENCA STATISTIKORE PËR ÇËSHJTJET CIVILE PËR GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM (FORMULARI NR. 6)

Në kolonën kryesore **“Iloji i çështjeve”**, përshtkruhen sipas kategorive të tyre:

- PADI ME PALË KUNDËRSHTARE:

- çështjet civile në përgjithësi;
- çështjet familjare;
- çështjet administrative;
- çështjet tregtare.

- KËRKESA PA KUNDËRSHTARË:

- çështjet civile në përgjithësi;
- çështjet familjare;
- çështje tregtare

Në fillim përcaktohen paditë me palë kundërshtare dhe më pas kërkesat.

- Në kolonën 1, **“çështjet e pambyllura”**, përcaktohen ato çështje të cilat ishin të papërfunduara/ në pritje të gjykimit në 3-mujorin paraardhës.

- Në kolonën 2, **“çështje të ardhur të reja”**, shënohen çështjet e ardhura gjatë periudhës së plotësimit të formularit, kurse në kolonën 3, **“çështjet e ardhura pas prishjes”**, shënohen çështjet e kthyera nga gjykatat e shkallës së dytë (Apeli).

- Kolona 4 **“shuma”**, duhet të jetë e barabartë me shumën e kolonave **1+2+3**.

MËNYRA E PËRFUNDIMIT

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”**, përcaktohet nga: **“çështjet e pranuar”** (kolona 5), **“zgjidhur me pajtim”** (kolona 6), **“refuzuar”** (kolona 7), **“pushuar”** (kolona 8), **“vendosur moskompetenca”** (kolona 9), **“përfunduar”** (kolona 10) dhe **“papërfunduar”**.

- Kolona 10 e të dhënave për çështjet e përfunduara, duhet të jetë e barabartë me shumën e kolonave 5+6+7+8+9, kurse kolona 11 duhet të jetë rezultat i diferencës së të dhënave të kolonës 4 me të dhënat e kolonës 10, d.m.th. $11=4-10$.

AFATI I PËRFUNDIMIT

Afati i përfundimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 12), **6 muaj – 1 vit** (kolona 13), **1-2 vjet** (kolona 14) dhe **mbi 2 vjet** (kolona 15).

- Tek **“Afati i përfundimit”** duhet që të dhënat e kolonave 12,13,14,15, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 10, pra $10 = (12+13+14+15+16)$.

- Në kolonën 16 do të hidhen të dhëna për **“çështjet e ankimuara”**, ndërsa në kolonat 17, 18, do të hidhen të dhënat për kërkesat për divorc **“me kërkesën e bashkëshortit/es”**.

- Për rastet e atyre padive ose kërkesave, baza ligjore e të cilave nuk rrjedh nga Kodi Civil, duhet të shënohet baza ligjore e ligjit që rregullon këtë çështje, si: Kodi Tregtar, Kodi i Familjes, ligji për falimentimin, ligji për pronësinë intelektuale etj.

C. EVIDENCA STATISTIKORE PËR NGARKESËN E GJYQTARËVE (FORMULARI NR. 7)

- Në kolonën nr. 1 vendoset emri dhe mbiemri i secilit gjyqtar.

- Kolona nr. 2 **“Çështje të gjykuara”** duhet të jetë shuma e kolonave 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10.

- Në kolonën nr. 3 dhe kolonën nr. 5 duhet të vendoset numri i çështjeve penale/civile të gjykuara nga secili gjyqtarë si **“i vetëm dhe kryesues”**.

- Në kolonën nr. 4 dhe kolonën nr. 6 duhet të vendoset numri i i çështjeve penale/civile të gjykuara nga secili gjyqtarë si pjesë në **“trup gjykues”**.

- Në kolonën nr. 7 dhe kolonën nr. 8 duhet të vendoset numri i çështjeve penale/civile të gjykuara nga gjyqtarë **“të deleguar”** në një tjetër gjykatë.

- Në kolonën nr. 9 dhe kolonën nr. 10 duhet të vendoset numri gjithsej i **“kërkesave penale”** dhe **“kërkesave civile”**.

- Në rreshtin **“Të komanduar”** shënohet vetëm numri gjithsej i gjyqtarëve të ardhur si të deleguar nga gjykatat e tjera pranë gjykatës që plotëson formularin.

D. EVIDENCA STATISTIKORE PËR SEANCAT PARAPRAKE (FORMULARI NR. 8)

- Në kolonën 1, vendoset **“Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”** e cila plotëson informacionin.



- Në kolonën 2, **“çështjet e pambyllura”**, përcaktohen ato çështje të cilat ishin të papërfunduara në 3-mujorin paraardhës/në pritje të gjykimit në 3-mujorin paraardhës.

- Në kolonën 3, **“çështje të ardhur të reja”**, shënohen çështjet e ardhura gjatë periudhës së plotësimit të formularit

- Kolona nr. 4 **“gjithsej”**, duhet të jetë shuma e kolonës nr. 2 **“çështje të pambyllura”** dhe kolonës nr. 3 **“të ardhura të reja”**.

MËNYRA E PËRFUNDIMIT

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”** përcaktohet nga: **“çështjet e pranuar”** (kolona 5), **“çështjet e pushuara”** (kolona 6), **“kaluar për gjykim”** (kolona 7), **“kthim për plotësim hetimesh (penale)”** (kolona 8), **“vendosur moskompetenca”** (kolona 9), **“të tjera”** (kolona 10) **“përfunduar”** (kolona 11) dhe **“pa përfunduar”** (kolona 12).

- Kolona 11 e të dhënave për çështjet e përfunduara, duhet të jetë e barabartë me shumën e kolonave **(5+6+7+8+9+10)**, kurse kolona 12 duhet të jetë rezultat i diferencës së të dhënave të kolonës 4, me të dhënat e kolonës 11, d.m.th. **12=(4-11)**.

SHPEJTËSIA NË GJYKIM

Afati i përfundimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **deri në 1 muaj** (kolona 13) dhe **mbi 1 muaj** (kolona 14).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 4, pra **4 = (5+6+7+8+9+10)**.

E. EVIDENCA STATISTIKORE PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR NË KUADËR TË E-PLATFORMËS² (FORMULARI NR. 9)

- Të dhënat statistikore që mblidhen nga gjykatat për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar shërbejnë për monitorimin e performancës së sistemit të drejtësisë dhe përdoren gjithashtu në kuadër të E-Platformës për Gjurmimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, të krijuar nga Komisioni Evropian. Kjo platformë përfshin si një mjet për gjurmimin e rasteve individuale, ashtu edhe një përmbledhje vjetore (*Yearly Overview*) të ecures së

ndjekjes penale dhe gjykimit të çështjeve, duke ofruar një pasqyrë të harmonizuar dhe të krahasueshme për vendet e zgjerimit të BE-së.

- Të dhënat që duhet të sjellin Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atij të Posaçëm, Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atij të Posaçëm dhe Gjykata e Lartë pasqyrojnë:

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Në kolonën 1: Numri i vendimeve me dënim të formës së prerë;

Në kolonën 2: Numri i personave të shpallur të pafajshëm;

Në kolonën 3: Numri i personave të dënuar me vendim të formës së prerë (pa apeluar).

Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Në kolonën 4: Numri i vendimeve me dënim të formës së prerë;

Në kolonën 5: Numri i personave të shpallur të pafajshëm;

Në kolonën 6: Numri i personave të dënuar me vendim të formës së prerë (pa apeluar).

Gjykata e Lartë

Në kolonën 7 - Numri i vendimeve me dënim të formës së prerë;

Në kolonën 8 - Numri i personave të shpallur të pafajshëm;

Në kolonën 9 - Numri i personave të dënuar me vendim të formës së prerë (pa apeluar).

Të dhënat e mësipërme bazuar në grupveprat që përfshijnë ndahen në:

- **Rreshti A.:** Kategoria **“Krimi i organizuar”** përfshin të gjitha çështjet penale që lidhen me veprat penale të parashikuara në Kodin Penal ose në ligje të veçanta që përcaktojnë vepra penale të kësaj natyre. Brenda kësaj kategorie, janë ndarë në mënyrë të veçantë disa grupe veprash penale, sipas objektit apo subjekteve të procedimit penal.

1: **Trafikimi i qenieve njerëzore** i cili në E-platform raportohet në seksionin **“Trafficking in human beings”**

² <https://organised-crime-corruption-track-record.ec.europa.eu/>



Neni 109 - Rrëmbimi ose pengmarrja; neni 109/b - Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë; neni 110/a - Trafikimi i personave; neni 128/b - Trafikimi i të miturve

2. Trafikimi i veprave të artit, kulturës dhe mjeteve motorike

Neni 138/a - Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës; neni 141/a - Trafikimi i mjeteve motorike (vetëm rastet me implikim ndërkombëtar, me përfshirjen e më shumë se një vendi)

3. Kontrabanda

Neni 175 - Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore; neni 176 - Kontrabanda e vlerave kulturore

4. Falsifikimi i parave

Neni 183 - Falsifikimi i monedhave; neni 184 - Falsifikimi i letrave me vlerë

5. Trafikimi i armëve i cili në E-platform raportohet në seksionin “Firearms related offenses”

Neni 278/a - Trafikimi i armëve dhe municioneve; neni 282/a - Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive

6. Trafikimi i lëndëve narkotike, i cili në E-platform raportohet në seksionin “Production/trafficking of drugs”

Neni 283 - Prodhimi dhe shitja e narkotikëve; neni 283/a - Trafikimi i narkotikëve; neni 284 - Kultivimi i bimëve narkotike; neni 284/a - Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale; neni 284/c - Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope; neni 284/ç - Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve.

7. Pastrimi i parave i cili në E-platform raportohet në seksionin “Money Laundering”

Neni 287 - Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale; Neni 287/b – Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

8. Terrorizmi i cili në E-platform raportohet në seksionin “Terrorism”

Neni 111 -Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera; Neni 230 – Vepra me qëllime terroriste; neni 230/a - Financimi i terrorizmit; neni 230/b - Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin; neni 230/c - Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit; neni 230/ç - Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur; neni 230/d – Grumbullimi i

fondeve për financimin e terrorizmit; neni 231 – Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit; neni 232 – Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste; neni 232/a – Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste; neni 232/b – Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste; neni 233 - Krijimi i bandave të armatosura; neni 234 - Prodhimi i armëve luftarake; neni 234/a -Organizatrat terroriste; neni 234/b - Bandat e armatosura.

9. Vepra penale të krimit të organizuar

Neni 333: Organizata kriminale; neni 333/a: Grupi i Strukturuar Kriminal; neni 334: Kryerja e veprave nga organizata kriminale dhe Grupi i Strukturuar Kriminal.

10. Krimet në internet (mashttrimet kompjuterike) i cili në E-platform raportohet në seksionin “Cybercrime”

Neni 143/b - Mashtrimi kompjuterik

- **Rreshti B:** Kategoria “**Korrupsioni**” përfshin të gjitha çështjet penale që lidhen me veprat penale të parashikuara në Kodin Penal ose në ligje të veçanta që përcaktojnë vepra penale të kësaj natyre. Brenda kësaj kategorie, janë ndarë në mënyrë të veçantë disa grupe veprash penale, sipas objektit apo subjekteve të procedimit penal.

1. Korrupsioni në sektorin publik

Neni 135 - Vjedhje me shpërdorim detyrë (vetëm për zyrtaret e lartë shtetërorë); neni 244 - Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike; neni 244/a - Korrupsion aktiv i nëpunësve të huaj publikë; neni 245/1 - Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të zyrtarët publikë; neni 248 - Shpërdorimi i detyrës; neni 256 - Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti; neni 258 -Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike; neni 259 - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike; neni 259/a - Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë.

2. Konflikti i interesit dhe deklarimi i pasurive

Neni 257 - Përfitimi i paligjshëm i interesave; neni 257/a - Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim.

3. Korrupsioni i nivelit të lartë

Neni 245 - Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë; neni 260



- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë.

4. Korrupsioni në sistemin gjyqësor

Neni 312 - Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit; neni 319 - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë; neni 319/a - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare; neni 319/b - Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj; neni 319/c - Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja; neni 319/ç - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë; neni 319/d - Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/dh - Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj; Neni 319/e - Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja.

5. Korrupsioni në sektorin privat

Neni 164 -Shpërdorimi i kompetencave; neni 164/a -Korrupsioni aktiv në sektorin privat.

6. Falsifikimi

Neni 186 - Falsifikimi i dokumenteve; neni 186/a - Falsifikimi kompjuterik; neni 189 - Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave; neni 190 - Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve.

F. EVIDENCA STATISTIKORE PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE PËR GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË (FORMULARI NR. 1)

Në kolonën kryesore, **“Iloji i çështjeve”**, përshkruhen sipas kategorive të tyre:

- PADI ME PALË KUNDËRSHTARE:

- çështjet civile në përgjithësi;

- çështjet administrative;

- KËRKESA PA KUNDËRSHTARË:

- çështjet civile në përgjithësi;

Në fillim përcaktohen paditë me palë kundërshtare dhe më pas kërkesat.

- Në kolonën 1, **“çështjet e pambyllura”**, përcaktohen ato çështje të cilat rezultojnë të papërfunduara në 3-mujorin paraardhës/në pritje të gjykimit në fillim të periudhës.

- Në kolonën 2, **“çështje të ardhur të reja”**, shënohen çështjet e ardhura gjatë periudhës së plotësimit të formularit, kurse në kolonën 3, **“çështjet e ardhura pas prishjes”**, shënohen çështjet e kthyer nga gjykatat e shkallës së dytë (Apeli).

- Kolona 4, duhet të jetë e barabartë me shumën e kolonave **1+2+3**.

MËNYRA E PËRFUNDIMIT

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”** përcaktohet nga: **“çështjet e pranuar”** (kolona 5), **“zgjidhur me pajtim”** (kolona 6), **“refuzuar”** (kolona 7), **“pushuar”** (kolona 8), **“vendosur moskompetenca”** (kolona 9), **“përfunduar”** (kolona 10) dhe **“pa përfunduar”** (kolona 11).

- Kolona 10 e të dhënave për çështjet e përfunduara, duhet të jetë e barabartë me shumën e kolonave (**5+6+7+8+9**), kurse kolona 11 duhet të jetë rezultat i diferencës së të dhënave të kolonës 4, me të dhënat e kolonës 10, d.m.th. **11=(4-10)**.

AFATI I PËRFUNDIMIT

Afati i përfundimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 12), **6 muaj – 1 vit** (kolona 13) dhe **mbi 1 vit** (kolona 14).

- Tek **“Afati i përfundimit”** duhet që të dhënat e kolonave 12,13,14,15, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 10, pra **10 = (12+13+14)**.

- Në kolonën 15 do të hidhen të dhëna për **“çështjet e ankimuara”**.

REZULTATI I ÇËSHTJEVE

- Për të pasqyruar në mënyrë më të plotë rezultatin e proceseve administrative gjyqësore, në evidencë do të shtohen dy kolona të veçanta. Njëra do të evidentojë numrin e çështjeve të vendosura në favor të shtetit (administratës publike kolona 15), ndërsa tjetra do të pasqyrojë çështjet e vendosura në favor të paditësit (individit apo subjektit privat kolona 16).

G. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE ADMINISTRATIVE PËR GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjelli gjykata e apelit për çështjet administrative pasqyrojnë: në kolonën nr. a, Gjykatën nga e cila vjen çështja.

- Në kolonën nr. 1, **“çështjet e pambyllura”**, shënohen të dhënat të cilat përbëjnë numrin e atyre çështjeve që në fund të periudhës së mëparshme ishin të papërfunduara/ në pritje të gjykimit.

- Në kolonën nr. 2, **“çështjet e ardhura”** gjatë 3/mujorit dhe në kolonën nr. 3, **“gjithsej”** çështje për gjykim, të bëhet rakordimi sipas barazimit: (**3 =1+2**).



- **“Përfundimi”** përcaktohet nga: **“shqyrtuar” dhe “në dorë”**. Shuma e kolonave 4, 5, duhet të jetë e barabartë me të dhënat e kolonës 3 (gjithsej çështjet).

- **“Mënyra e përfundimit të çështjeve”** përcaktohet nga: **“moskompetencë lëndore”, “lënie në fuqi”, “prishur për rigjykim”, “prishur dhe pushuar”, “pushuar dhe rrëzuar”, “pushuar dhe hequr dorë”, “ndryshuar” dhe “ndryshuar për shkaqe të tjera”**.

- Kolonat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, duhet të japin shumën e çështjeve të shqyrtuara të kolonës Nr. 4, pra $4 = (6+7+8+9+10+11+12+13)$.

AFATI I SHQYRTIMIT

Afati i shqyrtimit do të llogaritet nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Afatet në tabelë do të jenë:

- Nga **0–6 muaj** (kolona 14), **6 muaj – 1 vit** (kolona 15), **mbi 1 vit** (kolona 16).

- Tek **“Afati i shqyrtimit”**, duhet që të dhënat e kolonave 14, 15 dhe 16, si shumë të përputhen me të dhënat në kolonën 4, pra $4 = (14+15+16)$.

REZULTATI I ÇËSHTJEVE

- Për të pasqyruar në mënyrë më të plotë rezultatin e proceseve administrative gjyqësore, në evidencë do të shtohen dy kolona të veçanta. Njëra do të evidentojë numrin e çështjeve të vendosura në favor të shtetit (administratës publike kolona 17), ndërsa tjetra do të pasqyrojë çështjet e vendosura në favor të paditësit (individit apo subjektit privat kolona 18).

H. EVIDENCA STATISTIKORE GJYKATA E LARTË

1. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE PENALE PËR GJYKATËN E LARTË (FORMULARI NR. 1)

- Në të dhënat statistikore që duhet të paraqesë Gjykata e Lartë, në kolonën “nr. a” pasqyrohen gjykatat që kanë dërguar rekurs në Gjykatën e Lartë: ÇËSHTJE

- **Kolona 1: Çështje të pambyllura**, shënohet numri i atyre çështjeve që në fund të 3-mujorit të mëparshëm kanë rezultuar të papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fillim të periudhës.

- **Kolona 2: Çështje të ardhura**: Numri i çështjeve penale të reja që janë regjistruar në këto gjykata gjatë periudhës raportuese.

- **Kolona 3: Gjithsej**, përmbledhen të dyja kategoritë e mësipërme – çështjet mbartur + ardhur

(kolona 1 + kolona 2) duke paraqitur ngarkesën totale të trajtuar në këtë periudhë nga gjykatat.

PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE

- **Kolona 4: Çështje të përfunduara**, numri i çështjeve penale që janë mbyllur përmes një vendimi gjatë periudhës raportuese, qoftë me vendim për fajësi, pafajësi, pushim etj.

- **Kolona 5: Çështje të papërfunduara**, e cila përmban numrin e çështjeve të mbetura “pa përfunduara” ose që janë në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

NGA ÇËSHTJET E PËRFUNDUARA, NDARJA BËHET SI VIJON:

- **Kolona 6: Mospranim rekursi** – Ky vendim nënkupton që Gjykata e Lartë nuk e pranon rekursin për shqyrtim, zakonisht për arsye formale si mungesa e kushteve ligjore, tejkalimi i afatit apo mosplotësimi i kriterëve të pranueshmërisë.

- **Kolona 7: Prishur dhe kthyer për rigjykim/Prishur (pafajësi)** – Këtu përfshihen rastet kur Gjykata e Lartë prish vendimin e mëparshëm dhe e kthen çështjen për rigjykim, ose e prish vendimin duke shpallur pafajësi.

- **Kolona 8: Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Lënie në fuqi me ndryshime** – Kur Gjykata e Lartë vendos të lërë në fuqi vendimin e Apelit, qoftë plotësisht apo me ndryshime të pjesshme në arsyetim ose në dispozitiv.

- **Kolona 9: Prishje vendimi të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe lënien në fuqi të vendimit të Gj. së Shkallës së Parë** – Rastet kur Gjykata e Lartë anulon vendimin e Apelit dhe rikthen në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

- **Kolona 10: Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe/ose Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm** – Kur Gjykata e Lartë ndryshon pjesërisht ose plotësisht vendimin e Apelit dhe/ose të gjykatës së shkallës së parë, pa e prishur tërësisht.

- **Kolona 11: Pezullim/revokim ekzekutim vendimi/konstatim shkelje afati/përgjashtim gjyqtari** – Përfshin vendime që kanë të bëjnë me pezullimin apo revokimin e ekzekutimit të një vendimi, konstatimin e shkeljeve të afateve procedurale apo përgjashtimin e gjyqtarëve për shkak të konfliktit të interesit apo parregullsive.



- **Kolona 12: Pranim/rrëzim kërkesë / rishikim vendimi/sqarim interpretimi/ndreqje gabimi** – Vendime që lidhen me trajtimin e kërkesave për rishikim, kërkesa për sqarim, ndreqje gabimesh ose vendime mbi pranimin ose rrëzimin e kërkesave procedurale.

- **Kolona 13: Kthim rekursi/kërkese/aktesh** – Rastet kur Gjykata e Lartë kthen rekursin ose aktet për plotësim, korrigjim apo për mungesë të kompetencës për shqyrtim.

- **Kolona 14: Zgjidhje mosmarrëveshje kompetence/juridiksioni** – Përfshin vendimet që lidhen me përcaktimin e gjykatës kompetente për shqyrtimin e çështjes ose për zgjidhjen e konflikteve të juridiksionit ndërmjet gjykatave.

- **Kolona 15: Pushim gjykimi** – Vendime për pushimin e çështjes, zakonisht për mungesë objekt gjykimi, tërheqje nga padia ose vdekje të paditësit/ të pandehurit.

- **Kolona 16: Kthyer për rihetim** – Rastet kur çështja kthehet për rihetim (hetim të ri penal) nga organet procedurale për shkak të nevojës për sqarime të mëtejshme faktike apo juridike.

AFATET E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE

Tregojnë sa kohë i është dashur gjykatës për të shqyrtuar çështjet penale dhe për të marrë vendim:

- **Kolona 17: Deri në 1 muaj**, numri i çështjeve të shqyrtuara dhe përfunduar brenda 30 ditëve nga regjistrimi.

- **Kolona 18: 1 – 2 muaj**, numri i çështjeve të mbyllura brenda intervalit kohor 31–60 ditë.

- **Kolona 19: mbi 2 muaj**, numri i çështjeve që janë shqyrtuar dhe përfunduar pas më shumë se 60 ditësh.

2. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE CIVILE PËR GJYKATËN E LARTË (FORMULARI NR. 2)

Në të dhënat statistikore që duhet të paraqesë Gjykata e Lartë, në kolonën “nr. a” pasqyrohen gjykatat që kanë dërguar rekurs në Gjykatën e Lartë:

ÇËSHTJE

- **Kolona 1: Çështje të pambyllura**, shënohet numri i atyre çështjeve që në fund të 3-mujorit të mëparshëm kanë rezultuar të papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fillim të periudhës.

- **Kolona 2: Çështje të ardhura**: Numri i çështjeve civile të reja që janë regjistruar në këto gjykata gjatë periudhës raportuese.

- **Kolona 3: Gjithsej**, përmbledhen të dyja kategoritë e mësipërme – çështjet mbartur + ardhur

(kolona 1 + kolona 2) duke paraqitur ngarkesën totale të trajtuar në këtë periudhë nga gjykatat.

PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE

- **Kolona 4: Çështje të përfunduara**, numri i çështjeve civile që janë mbyllur përmes një vendimi gjatë periudhës raportuese.

- **Kolona 5: Çështje të papërfunduara**, e cila përmban numrin e çështjeve të mbetura “pa përfunduar” ose që janë në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

NGA ÇËSHTJET E PËRFUNDUARA, NDARJA BËHET SI VIJON:

- **Kolona 6: Mospranim rekursi** – Raste kur Gjykata e Lartë vendos të mos e pranojë rekursin për shqyrtim për arsye procedurale apo për mungesë të kushteve ligjore të pranueshmërisë.

- **Kolona 7: Prishur dhe kthyer për rigjykim** – Raste kur Gjykata e Lartë prish vendimin dhe e kthen çështjen për gjykim të ri në një gjykatë më të ulët.

- **Kolona 8: Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm/Lënie në fuqi me ndryshime** – Raste kur Gjykata e Lartë lë në fuqi vendimin e Apelit siç është ose me ndryshime të pjesshme në arsyetim apo dispozitiv.

- **Kolona 9: Prishje vendimi të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë** – Raste kur Gjykata e Lartë anulon vendimin e Apelit dhe rikthen në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

- **Kolona 10: Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe/ose Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm** – Raste kur Gjykata e Lartë ndryshon plotësisht ose pjesërisht vendimin e një prej instancave më të ulëta pa e prishur tërësisht atë.

- **Kolona 11: Pezullim ekzekutim vendimi/konstatim shkelje afati/përrjashtim gjyqtari** – Vendime që lidhen me pezullimin e ekzekutimit të një vendimi, konstatimin e shkeljes së afateve procedurale ose përrjashtimin e gjyqtarit për shkak të paragjykimit ose konfliktit të interesit.

- **Kolona 12: Pranim/rrëzim kërkesë / rishikim vendimi/sqarim interpretimi/ndreqje gabimi/sigurim padie** – Raste që përfshijnë vendimmarrje mbi kërkesa procedurale si rishikime,



sqarime, ndreqje teknike, pranim ose rrëzim të kërkesës, apo edhe masa të sigurimit të padisë.

- **Kolona 13: Kthim rekursi/kërkese/aktesh** – Raste kur rekursi, kërkesa ose aktet kthehen për mungesë të plotësimeve formale, kompetencë ose trajtim të mëtëjshëm nga gjykatat më të ulëta.

- **Kolona 14: Zgjidhje mosmarrëveshje kompetence/juridiksioni** – Vendime të Gjykatës së Lartë që përcaktojnë gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes në rast konflikti kompetencash apo juridiksioni.

- **Kolona 15: Pushim gjykimi/hequr dorë** – Raste kur procedimi gjyqësor pushohet për arsye si tërheqja nga padia, mospasja më e objektit të gjykimit apo shkaqe të tjera ligjore që pengojnë vijimin e procesit.

AFATET E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE

Tregojnë sa kohë i është dashur gjykatës për të shqyrtuar çështjet civile dhe për të marrë vendim:

- **Kolona 16: Deri në 1 muaj**, numri i çështjeve të shqyrtuara dhe përfunduar brenda 30 ditëve nga regjistrimi.

- **Kolona 17: 1–2 muaj**, numri i çështjeve të mbyllura brenda intervalit kohor 31–60 ditë.

- **Kolona 18: mbi 2 muaj**, numri i çështjeve që janë shqyrtuar dhe përfunduar pas më shumë se 60 ditësh.

3. EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE ADMINISTRATIVE PËR GJYKATËN E LARTË (FORMULARI NR. 3)

Në të dhënat statistikore që duhet të paraqesë Gjykata e Lartë, në kolonën “nr. a” pasqyrohen gjykatat që kanë dërguar rekurs në Gjykatën e Lartë: ÇËSHTJE

- **Kolona 1: Çështje të pambyllura**, shënohet numri i atyre çështjeve që në fund të 3-mujorit të mëparshëm kanë rezultuar të papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fillim të periudhës.

- **Kolona 2: Çështje të ardhura**: Numri i çështjeve administrative të reja që janë regjistruar në këto gjykata gjatë periudhës raportuese.

- **Kolona 3: Gjithsej**, përmbledhen të dyja kategoritë e mësipërme – çështjet mbartur + ardhur (kolona 1 + kolona 2) duke paraqitur ngarkesën totale të trajtuar në këtë periudhë nga gjykatat.

PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE

- **Kolona 4: Çështje të përfunduara**, numri i çështjeve administrative që janë mbyllur përmes një vendimi gjatë periudhës raportuese.

- **Kolona 5: Çështje të papërfunduara**, e cila përmban numrin e çështjeve të mbetura “pa përfunduara” ose që janë në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

NGA ÇËSHTJET E PËRFUNDUARA, NDARJA BËHET SI VIJON:

- **Kolona 6: Mospranim rekursi** – Raste kur Gjykata e Lartë vendos të mos e pranojë për shqyrtim rekursin për arsye procedurale, si mungesa e kushteve të pranueshmërisë apo shkelje formale të ligjit.

- **Kolona 7: Prishur dhe kthyer për rigjykim** – Raste kur Gjykata e Lartë prish vendimin e mëparshëm dhe e kthen çështjen për gjykim të ri në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ose në Apel, për një shqyrtim të plotë dhe të saktë të çështjes.

- **Kolona 8: Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit/Lënie në fuqi me ndryshime** – Raste kur Gjykata e Lartë e vlerëson vendimin e Apelit të drejtë dhe e lë në fuqi siç është ose me modifikime të vogla në interpretim apo dispozitiv.

- **Kolona 9: Prishje vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë** – Raste kur Gjykata e Lartë rrëzon vendimin e Apelit dhe rikthen në fuqi vendimin e mëparshëm të Shkallës së Parë, duke e konsideruar atë më të drejtë në përmbajtje.

- **Kolona 10: Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe/ose Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë** – Raste kur Gjykata e Lartë ndryshon pjesërisht ose plotësisht vendimet e instancave më të ulëta, pa i prishur tërësisht ato.

- **Kolona 11: Pezullim ekzekutim vendimi/konstatim shkelje afati/përrjashtim gjyqtari** – Vendime që kanë të bëjnë me pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të një vendimi administrativ, konstatimin e tejkalimit të afateve procedurale apo përrjashtimin e gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes për shkak të papërshtatshmërisë ligjore.

- **Kolona 12: Pranim/rrëzim kërkesë / rishikim vendimi/sqarim interpretimi/ndreqje gabimi/sigurim padie** – Kjo kolonë përfshin veprime procedurale të Gjykatës së Lartë si shqyrtimi i kërkesave për rishikim, ndreqje gabimesh, dhënie sqarimesh për interpretim të



vendimit, si dhe pranimi apo rrëzimi i kërkesave për masa sigurie (p.sh. sigurim padie).

- **Kolona 13: Kthim rekursi/kërkese/aktesh** – Raste kur Gjykata e Lartë vendos të kthejë rekursin, kërkesën apo aktet për shkak të mangësive procedurale, mungesës së kompetencës apo për plotësim dokumentacioni.

- **Kolona 14: Zgjidhje mosmarrëveshje kompetence/juridiksioni** – Vendime që zgjidhin konfliktet ndërmjet gjykatave lidhur me kompetencën materiale apo territoriale për shqyrtimin e një çështjeje administrative.

- **Kolona 15: Pushim gjykimi/hequr dorë** – Raste kur gjykimi pushohet, zakonisht për shkak të tërheqjes nga padia, mungesës së objektit të gjykimit ose për arsye të tjera procedurale të parashikuara në ligj.

AFATET E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE

Tregojnë sa kohë i është dashur gjykatës për të shqyrtuar çështjet administrative dhe për të marrë vendim:

- **Kolona 16: Deri në 1 muaj**, numri i çështjeve të shqyrtuara dhe përfunduar brenda 30 ditëve nga regjistrimi.

- **Kolona 17: 1 – 2 muaj**, numri i çështjeve të mbyllura brenda intervalit kohor 31 – 60 ditë.

- **Kolona 18: mbi 2 muaj**, numri i çështjeve që janë shqyrtuar dhe përfunduar pas më shumë se 60 ditësh.

I. EVIDENCA STATISTIKORE PËR TREGUESITË E FCIENCËS NË GJYKATAT E TË TRIA NIVELEVE NGA KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR (FORMULARI NR. 1)

- Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë KLGJ pasqyrohen: në kolonën nr. **a**, Gjykatat të cilave u përkasin të dhënat për treguesit e eficiencës;

- Gjykatat do të kategorizohen sipas nivelit (shkallës) dhe llojit të juridiksionit, në mënyrë që matja e efikasitetit të reflektojë ngarkesën dhe performancën për secilën shkallë gjyqësore, për çdo juridiksion dhe për secilin lloj çështjeje që trajtohet në këto gjykata.

- **Rreshti A: Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm** – Të dhënat do të përfshijnë të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat treguesit raportohen në mënyrë individuale, ndërsa në rreshtin A do të paraqitet treguesi i përgjithshëm i efikasitetit për të gjitha këto gjykata të marra së bashku.

- **Rreshti B: Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë** - Të dhënat do të përfshijnë të gjitha Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, për të cilat treguesit raportohen në mënyrë individuale, ndërsa në rreshtin B do të paraqitet treguesi i përgjithshëm i efikasitetit për të gjitha këto gjykata të marra së bashku.

- **Rreshti C: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**

- **Rreshti D: Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm**

- **Rreshti E: Gjykata Administrative e Apelit**

- **Rreshti F: Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**

- **Rreshti G: Gjykata e Lartë**

ÇËSHTJE PENALE

- **Kolona 1: Norma e likuidimit të çështjeve (%)** është raporti i përfutur nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje.

- **Kolona 2: Koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë)** është raporti i çështjeve papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë.

- **Kolona 3: Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës** përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- **Kolona 4: Përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet** tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

ÇËSHTJE CIVILE

- **Kolona 5: Norma e likuidimit të çështjeve (%)** është raporti i përfutur nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje.

- **Kolona 6: Koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë)** është raporti i çështjeve papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë.

- **Kolona 7: Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës** përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.



- **Kolona 8: Përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet** tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

ÇËSHITJE ADMINISTRATIVE

- **Kolona 9: Norma e likuidimit të çështjeve (%)** është raporti i përfutur nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje.

- **Kolona 10: Koha deri në zgjidhjen e çështjes/koha e disponimit (në ditë)** është raporti i çështjeve papërfunduara/ në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë.

- **Kolona 11: Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës** përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- **Kolona 12: Përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet** tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës.

J. EVIDENCA STATISTIKORE MBI STRUKTURËN DHE SHPËRNDARJEN E MAGJISTRATËVE NË TË GJITHA GJYKATAT, BAZUAR NË TË DHËNAT E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR (FORMULARI NR. 2)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë KLGJ-ja pasqyrohen: në kolonën nr. **a**, Gjykatën të cilës i përketin të dhënat për magistratët faktik dhe numrin e vakancave përkatëse;

- **Rreshti A:** Kategoria përfshin të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;

- **Rreshti B:** Kategoria përfshin të gjitha Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

- **Rreshti C:** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

- **Rreshti D:** Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

- **Rreshti E:** Gjykata Administrative e Apelit

- **Rreshti F:** Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

- **Rreshti G:** Gjykata e Lartë

PËRBËRJA E MAGJISTRATËVE NË GJYKATA

- **Kolona 1: Femra:** Numri aktual i **magjistrateve femra** (gjyqtare) që janë në detyrë në gjykatën përkatëse.

- **Kolona 2: Meshkuj:** Numri i **magjistratëve meshkuj** (gjyqtarë) aktualisht në detyrë në të njëjtën gjykatë.

- **Kolona 3: Totali i magjistratëve aktualisht:** **Shuma totale** e magjistratëve (femra + meshkuj) që janë aktualisht aktivë dhe në detyrë në gjykatë (për qëllime të kësaj table, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuar dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj. Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. Për shembull, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve “të punës” në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.).

- **Kolona 4: Vakanca aktualisht:** Numri i **vendeve bosh**, pra pozicione magistratësh që duhet të jenë të plotësuar sipas strukturës organizative por për momentin janë të paplotësuar.

- **Kolona 5: Totali i numrit të magjistratëve sipas strukturës organizative:** Numri i **parashikuar në organikë** për magistratë në atë gjykatë – përfshin si vendet e zëna, ashtu edhe ato vakante (kolona 5 = kolona 3 + kolona 4).

PËRBËRJA e kryetarëve në Gjykata

- **Kolona 6: Femra:** Numri i **kryetareve femra** në drejtimin e gjykatave.

- **Kolona 7: Meshkuj:** Numri i **kryetarëve meshkuj** që mbajnë pozicionin drejtues të gjykatave.

- **Kolona 8: Vakanca aktualisht:** Numri i gjykatave që aktualisht nuk kanë një kryetar të



emëruar, pra janë në pritje të plotësimit të pozicionit drejtues.

K. EVIDENCA STATISTIKORE PËR PËRBËRJEN E STRUKTURËS FAKTIKE DHE ORGANIZATIVE NË TË GJITHA PROKURORITË NGA KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë KLP-ja pasqyrohen: në kolonën nr. “a”, Prokuroria të cilës i përkasin të dhënat për magistratët faktik dhe numrin e vakancave përkatëse.

- **Rreshti A:** Kategoria përfshin të gjitha Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

- **Rreshti B:** Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

- **Rreshti C:** Prokuroria e Posaçme

- **Rreshti D:** Prokuroria e Përgjithshme

PËRBËRJA E MAGJISTRATËVE NË PROKURORI

- **Kolona 1: Femra:** Numri aktual i **magjistrateve femra** (prokurore) që janë në detyrë në prokurorinë përkatëse.

- **Kolona 2: Meshkuj:** Numri i **magjistratëve meshkuj** (prokurore) aktualisht në detyrë në të njëjtën prokurori.

- **Kolona 3: Totali i magjistratëve aktualisht:** **Shuma totale** e magjistratëve (femra + meshkuj) që janë aktualisht aktivë dhe në detyrë në prokurori. (për qëllime të kësaj table, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në prokurori (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuar dhe jo numri në organikën e prokurorisë). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj. Kjo do të thotë se numri i prokurorëve që punojnë me kohë të pjesshme ose prokurorëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. Për shembull, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin prokuror, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve “të punës” në prokurori me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

VAKANCAT

- **Kolona 4 – Vakanca të përhershme:**

Përfaqëson numrin e vendeve të lira në strukturën organizative që janë krijuar si rezultat i largimit përfundimtar të magistratëve (p.sh., dorëheqje, pensionim, shkarkim), dhe që kërkojnë plotësim të qëndrueshëm përmes procedurave standarde të emërimit.

- **Kolona 5 – Vakanca të krijuara nga komandimi:** Shënon numrin e vendeve të lira të përkohshme që rezultojnë nga komandimi i magistratëve në institucione të tjera, jashtë pozicionit të tyre të përhershëm, për një periudhë të caktuar kohore.

- **Kolona 6 – Vakanca për shkak të lejes prindërore:** Tregon numrin e vendeve të përkohshme të lira që lindin nga përfitimi i të drejtës së lejes prindërore nga magistratët, sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe statusin e magistratit.

- **Kolona 7 – Vakanca për shkak të emërimit në këshill:** Përfshin numrin e pozicioneve të përkohshme të lira të krijuara për shkak të zgjedhjes ose emërimit të magistratëve në KLP.

- **Kolona 8 – Vakanca për shkak të pezullimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK):**

Shënon numrin e vendeve të lira përkohësisht, si pasojë e pezullimit nga funksioni të magistratëve që janë subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas legjislacionit të vetëgut.

- **Kolona 9 – Totali i vakancave të magistratëve në sistemin e prokurorisë:** Përfshin vakancat e përhershme dhe ato të përkohshme dhe shprehet si shuma e kolonave $4+5+6+7+8=9$.

- **Kolona 10 – Numri total i magistratëve sipas strukturës organizative:** Përfaqëson shifrën e përgjithshme të magistratëve të parashikuar në organikë, përfshirë si pozicionet e mbuluara aktualisht, ashtu edhe ato që rezultojnë vakante për arsye të përhershme ose të përkohshme (shprehet si shuma e kolonave $3+9=10$).

PËRBËRJA E DREJTUESVE NË PROKURORI

- **Kolona 11 – Femra:** Numri i **drejtueseve femra** në drejtimin e prokurorive.

- **Kolona 12 – Meshkuj:** Numri i **drejtuesve meshkuj** që mbajnë pozicionin drejtues të prokurorive.



- **Kolona 13 – Vakanca aktualisht:** Numri i prokurorëve që aktualisht nuk kanë një drejtues të emëruar, pra janë në pritje të plotësimit të pozicionit drejtues.

L. EVIDENCA STATISTIKORE E PROCEDIMEVE PENALE NGA PROKURORIA E POSAÇME (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë Prokuroria e Posaçme pasqyrohen: në kolonën nr. **a**, Nenet e Kodit Penal për të cilët lidhen të dhënat e paraqitura në kolona.

Tabela përmban një strukturë të detajuar statistikore mbi të gjitha procedimet penale të regjistruara, të mbartura dhe të trajtuara nga Prokuroria e Posaçme. Informacioni është i organizuar sipas veprave penale dhe neneve të Kodit Penal dhe mbulon të gjitha fazat e hetimit dhe gjykimin, si dhe masat e marra ndaj të hetuarve.

Përmbajtja kryesore përfshin:

- **Klasifikimin e çështjeve sipas burimit:**

- Çështje të mbartura nga viti i mëparshëm
- Çështje të regjistruara rishtas gjatë vitit
- Çështje të regjistruara kryesisht nga prokurori
- Çështje të rifilluara pas pushimi ose pezullimi
- Çështje të ardhura nga transferimi për shkak të moskompetencës

- Çështje të bashkuara me procedime ekzistuese

- **Ndarja e personave nën hetim:**

- Sipas statusit ligjor: subjekt i përgjithshëm dhe subjekt i posaçëm

- Sipas masës së sigurisë: arrest me burg dhe masa të tjera sigurimi

- Evidentimi i rasteve me autor të panjohur apo të pandehur të sëmurë

- **Masat e sigurimit pasuror:**

- Numri i kërkesave për sekuestrim preventive

- Numri i vendimeve për sekuestrim të dhëna nga gjykata

- Ankime dhe rekurse të paraqitura ndaj vendimeve për sekuestrim

- Vlera totale e pasurive të sekuestruara sipas vlerësimeve financiare

- **Faza gjyqësore e procedimeve:**

- Çështjet e dërguara për gjykim
- Pushimet e çështjeve dhe të akuzave

Gjendja e çështjeve në:

- Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë
- Gjykatën e Posaçme të Apelit
- Gjykatën e Lartë

- Gjykatën Kushtetuese

- **Rezultatet e gjykimeve:**

- Vendime pafajësie (të pjesshme ose të plota)
- Dënime me burgim ose burgim të përjetshëm
- Dënime alternative
- Vendime gjobe
- Marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe urdhra

penalë

- **Vendimet për konfiskim:**

- Numri i kërkesave për konfiskim
- Vendime të dhëna për konfiskim
- Vlerësimi i pasurive të konfiskuara

M. EVIDENCA STATISTIKORE PËR KALLËZIMET DHE REFERIMET PROKURORIA E POSAÇME (FORMULARI NR. 2)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë SPAK-u pasqyrohen: në kolonën nr. **a**, nenet e Kodit Penal për të cilët lidhen të dhënat për kallëzimet dhe referimet në prokurori:

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë SPAK-u pasqyrohen: në kolonën nr. **a**, nenet e Kodit Penal për të cilët lidhen të dhënat për kallëzimet dhe referimet në prokurori:

Tabela përmbledh në mënyrë sistematike të gjitha kallëzimet penale dhe referimet që janë adresuar pranë SPAK-ut. Ai paraqet burimin, statusin procedural dhe mënyrën e përfundimit të çdo kallëzimi apo sinjalizimi penal, përfshirë kalimin në fazën hetimore ose vendimarrjen për mosfillim.

- **Të dhënat përfshijnë:**

- Kallëzime të mbartura nga periudha e mëparshme

- Kallëzime të regjistruara rishtas gjatë vitit

- Vendime për mosfillim të procedimit penal

- Kallëzime që kanë kaluar në fazën e regjistrimit si procedim penal

- Kallëzime të bashkuara me çështje ekzistuese për shkak të lidhjes objektive/subjektive

- **Origjina e kallëzimeve:**

- Nga Prokuroria (filluar kryesisht)

- Nga institucione publike, si:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit

- ILDKPKI

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

- Doganat

- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

- Institucione të tjera publike

- Nga individë të zakonshëm (shtetas)

- Nga subjekte të tjera



- Nga Policia e Shtetit

- Totali i kallëzimeve dhe referimeve të administruara për periudhën raportuese

N. EVIDENCA STATISTIKORE PËR VEPRIMTARINË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë ILD pasqyrohen: në kolonën nr. “a” Treguesit për të cilët lidhen të dhënat (shifrat) e paraqitura në kolonën 1:

- **Rreshti 1: Ankesa të shqyrtuara dhe raste kryesisht** - është numri i ankesave të shqyrtuara për periudhën e raportimit në një vendim përfundimtar të ILD-së (arkivim pas shqyrtimit fillestar dhe arkivim pas verifikimi të ankesës/ankesave). Raste kryesisht janë të gjitha informacionet apo të dhënat publike që verifikohet kryesisht nga ILD, për të cilat është vendosur arkivim pas verifikimit

- **Rreshti 2: Hetime** - përfshihet numri i të gjitha hetimeve të realizuara mbi bazë ankese apo kryesisht, për të cilat është vendosur mbyllje hetimi, për periudhën e raportimit.

- **Rreshti 3: Kërkesa për procedim disiplinor** - përfshihet numri i hetimeve të përfunduar me kërkesë për procedim disiplinor mbi bazë ankese dhe kryesisht, pranë Këshillave.

O. EVIDENCA STATISTIKORE PËR VEPRIMTARINË E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhet të sjellë SHM pasqyrohen: në kolonën “a” Subjektet të cilët përfitojnë nga trajnimet e Shkollës së Magjistraturës (magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjorë/këshilltarë):

- **Kolonat 1–3:** Paraqesin ndarjen tremujore të pjesëmarrjes në trajnim:

- **Kolona 1: Tetor–dhjetor**

- **Kolona 2: Janar–mars**

- **Kolona 3: Prill–qershor**

- **Kolona 4: Totali i vitit akademik** - Tregon totalin e subjekteve të trajnuara për secilën kategori gjatë gjithë vitit akademik, duke mbledhur të dhënat nga kolonat 1, 2 dhe 3.

P. EVIDENCAT STATISTIKORE MBI NGARKESËN E PUNËS SË PROKURORIVË BAZUAR NË TË DHËNAT E PROKURORISË SË PËRGJITHSHME (FORMULARI NR. 1)

Në të dhënat statistikore që duhen sjellë nga PP pasqyrohen:

- **Në kolonën a:** Prokurorisë të cilës i përketin të dhënat;

- **Rreshti A:** Kategoria përfshin të gjitha Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;

- **Rreshti B:** Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

- **Kolona 1 – “Mesatarja e çështjeve të ndjekura për prokuror”:** i) në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm paraqet numrin mesatar të procedimeve penale në ndjekje ku përfshihen çështjet e mbartura nga periudha e mëparshme, ato të reja të regjistruara gjatë periudhës së raportimit dhe çështjet e rifilluara, për prokuror faktik; ii) për prokurorinë e apelit të juridiksionit të përgjithshëm paraqet numrin mesatar të çështjeve penale për të cilat është përfaqësuar akuza në gjykimin në themel dhe për masat e sigurimit ku përfshihen çështjet e reja dhe ato të mbartura në gjykim, për prokuror faktik.

- **Kolona 2 – “Mesatarja e çështjeve të mbartura për prokuror”:** paraqet numrin mesatar të çështjeve penale të mbartura nga periudha paraardhëse në periudhën e raportimit, për prokuror faktik.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 160 lekë